

 REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH			
Njësia Org. Org.Jednica Org Unit	02	Nr.Prot: Broj Prot: Prot.No:	05-1164
Nr.i faqeve Br.stranica No.pages	- 70 -	Data: Datum: Date:	18,02,2021
Prishtinë / a			



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government



Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravstva / Ministry of Health

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

Nacionalni Institut za Javno Zdravstvo Kosova / National Institute Public Health of Kosova

Memorandum		
Data/Datum/Date	18.02.2021	Ref.Nr/Br/No
Për/Za/To	Z. Armend Zemaj / Minister i Shëndetësisë	
Përmes/Preko/Through	Z. Ardian Mehmetaj / Ud Sekretari i Përgjithshëm	
Nga/Od/From	Dr.Edita Haxhiu, UD Shefe e imunizimit, IK ShPK	
Lënda/Tema/Subject	Plani shtetëror i vaksinimit kundër COVID-19	
CC	Prof.dr Naser Ramadani, drejtor IKShPK	

I nderuar Z. Minister,

Grupi punues ka finalizuar hartimin e Plani Shtetëror i Vaksinimit kundër COVID – 19 Ky Plan është hartuar në pajtim me Ligji nr. 07/I-006 për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19 si dhe dokumentet e organizatave relevante ndërkombëtare në ballafaqim me Pandeminë COVID 19.

Të bashkëngjitur gjeni:

1. Formularin e vlerësimit të ndikimit buxhetor
2. Plani Shtetëror i Vaksinimit kundër COVID – 19

Me respekt,

Organi Propozues	Mistria e Shëndetsis
Titulli i Nismës se re	Plani Kombëtar i Kosovës për shpërndarjen dhe vaksinimin me vaksinat kundër COVID-19
Programi-Nën Programi:	Administrata Qendrore
Qëllimi i Nismës se re	Vaksinimi i popullatës me vaksinën anti COVID 19
Objektivat	
Objektivi 1	
Objektivi 2	
Objektivi 3	

Objekti	Produkti	Aktiviteti	Viti 0				Viti 1				Viti 2				Viti 3			
			Paga dhe Matëse	Matra dhe Shërbime Komunitare	Subvencione dhe Transfere	Shpenzimet Kapitale	Paga dhe Matëse	Matra dhe Shërbime Komunitare	Subvencione dhe Transfere	Shpenzimet Kapitale	Paga dhe Matëse	Matra dhe Shërbime Komunitare	Subvencione dhe Transfere	Shpenzimet Kapitale	Paga dhe Matëse	Matra dhe Shërbime Komunitare	Subvencione dhe Transfere	Shpenzimet Kapitale
Objekti 1	Produkti	VAKSINIMI I POPULLSIS		Sasia			Njësia Matëse	Sasia				Njësia Matëse	Sasia			Njësia Matëse	Sasia	
	Aktiviteti				0.00		0.00	36,093,093		1240000		0.00		0.00		0.00		0.00
	Aktiviteti						0.00	730,296				0.00				0.00		0.00
	Aktiviteti						0.00					0.00				0.00		0.00
	Aktiviteti						0.00					0.00				0.00		0.00
	Gjithësej sipas viteve						0.00	36,823,389.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
	Gjithësej për periudhën				0		0	36823389	Komunal	0		0	Subvencione dhe Transfere	0		0	Shpenzime Kapitale	0
Produkti	1 Përshatja e vendit të vaksinimit						0.00	500,000.00				0.00			0.00			0.00
	Aktiviteti						0.00					0.00			0.00			0.00
	Aktiviteti						0.00					0.00			0.00			0.00
	Aktiviteti						0.00	198,000.00		943,800.00		0.00			0.00			0.00
	Aktiviteti						0.00	150,000.00				0.00			0.00			0.00
	Gjithësej sipas viteve						0.00	848,000.00	0.00	0.00	943,800.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
	Gjithësej për periudhën				0		0	848000	Komunal	0	943800	0	Subvencione dhe Transfere	0	0	0	Shpenzime Kapitale	943800
Produkti	Njoni tjetri						0.00					0.00			0.00			0.00
	Aktiviteti						0.00					0.00			0.00			0.00
	Aktiviteti						0.00					0.00			0.00			0.00
	Aktiviteti						0.00	91,159.00		0.00	497,232.00	0.00			0.00			0.00
	Aktiviteti						0.00	154,000.00				0.00			0.00			0.00
	Aktiviteti						0.00	38,000.00				0.00			0.00			0.00
	Gjithësej sipas viteve						0.00	283,159.00	0.00	0.00	497,232.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
	Gjithësej për periudhën				0		0	283159	Komunal	0	497232	0	Subvencione dhe Transfere	0	0	0	Shpenzime Kapitale	497232
Objekti 2	Produkti	Trajnimi i punëtorëve shëndetësorë të përfshirë në imunizim dhe mbijetesë					0.00	27,000.00				0.00			0.00			0.00
	Aktiviteti						0.00	1,300.00				0.00			0.00			0.00
	Aktiviteti						0.00	680.00				0.00			0.00			0.00
	Aktiviteti						0.00	300.00				0.00			0.00			0.00
	Gjithësej sipas viteve						0.00	29,280.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
	Gjithësej për periudhën				0		0	29280	Komunal	0	0	0	Subvencione dhe Transfere	0	0	0	Shpenzime Kapitale	0
Produkti	Asistenca Teknike Ndërkombëtare për mbikëqyrjen dhe monitorimin						0.00	6,000.00				0.00			0.00			0.00
	Aktiviteti						0.00	10,000.00				0.00			0.00			0.00
	Aktiviteti						0.00	3,740.00				0.00			0.00			0.00
	Aktiviteti						0.00					109,200.00			0.00			0.00
	Gjithësej sipas viteve						0.00	19,740.00	0.00	0.00	109,200.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
	Gjithësej për periudhën				0		0	19740	Komunal	0	109200	0	Subvencione dhe Transfere	0	0	0	Shpenzime Kapitale	109200
Produkti	Printimi i materialeve/Kartat e imunizimit						0.00	378,000.00				0.00			0.00			0.00
	Aktiviteti						0.00	1,200.00				0.00			0.00			0.00
	Aktiviteti						0.00	1,000.00				0.00			0.00			0.00
	Aktiviteti						0.00	5,000.00				0.00			0.00			0.00
	Gjithësej sipas viteve						0.00	385,200.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
	Gjithësej për periudhën				0		0	385200	Komunal	0	0	0	Subvencione dhe Transfere	0	0	0	Shpenzime Kapitale	0
Objekti 3	Produkti	Analiza e të dhënave dhe zhvillimi i raportit					0.00	8,400.00				0.00			0.00			0.00
	Aktiviteti						0.00	13,000.00				0.00			0.00			0.00
	Aktiviteti						0.00	10,000.00				0.00			0.00			0.00
	Aktiviteti						0.00	5,000.00				0.00			0.00			0.00
	Gjithësej sipas viteve						0.00	36,400.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
	Gjithësej për periudhën				0		0	36400	Komunal	0	0	0	Subvencione dhe Transfere	0	0	0	Shpenzime Kapitale	0
Produkti	Zhvillimi i materialeve të komunikimit dhe informimit për të mbështetur						0.00	4,000.00				0.00			0.00			0.00
	Aktiviteti						0.00	20,000.00				0.00			0.00			0.00
	Aktiviteti						0.00	600.00				0.00			0.00			0.00
	Gjithësej sipas viteve						0.00	24,600.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
	Gjithësej për periudhën				0		0	24600	Komunal	0	0	0	Subvencione dhe Transfere	0	0	0	Shpenzime Kapitale	0
Produkti	Zhvillimi i materialeve të komunikimit dhe informimit për të mbështetur						0.00					0.00			0.00			0.00
	Aktiviteti						0.00					0.00			0.00			0.00
	Aktiviteti						0.00					0.00			0.00			0.00
	Aktiviteti						0.00					0.00			0.00			0.00
	Gjithësej sipas viteve						0.00		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
	Gjithësej për periudhën				0		0		0	0	0	Subvencione dhe Transfere	0	0	0	0	Shpenzime Kapitale	0

Mundësitë për kursime

Programi [Nënprogrami]	Kodi	Viti 0	Viti 1	Viti 2	Viti 3
Total		-	-	-	-
<i>Paga dhe mëditje</i>		-	-	-	-
<i>Mallra dhe shërbime</i>		-	-	-	-
<i>Komunali</i>		-	-	-	-
<i>Subvencione dhe transfere</i>		-	-	-	-
<i>Shpenzime Kapitale</i>		-	-	-	-
[Programi]		-	-	-	-
<i>Paga dhe mëditje</i>		-	-	-	-
<i>Mallra dhe shërbime</i>		-	-	-	-
<i>Komunali</i>		-	-	-	-
<i>Subvencione dhe transfere</i>		-	-	-	-
<i>Shpenzime Kapitale</i>		-	-	-	-
[Nënprogrami]	inspektorati she	-	-	-	-
<i>Paga dhe mëditje</i>					
<i>Mallra dhe shërbime</i>					
<i>Komunali</i>					
<i>Subvencione dhe transfere</i>			0.00		
<i>Shpenzime Kapitale</i>					
[Nënprogrami]		-	-	-	-
<i>Paga dhe mëditje</i>					
<i>Mallra dhe shërbime</i>					
<i>Komunali</i>					
<i>Subvencione dhe transfere</i>					
<i>Shpenzime Kapitale</i>					
[Nënprogrami]		-	-	-	-
<i>Paga dhe mëditje</i>					
<i>Mallra dhe shërbime</i>					
<i>Komunali</i>					
<i>Subvencione dhe transfere</i>					
<i>Shpenzime Kapitale</i>					
[Programi]		-	-	-	-
<i>Paga dhe mëditje</i>		-	-	-	-
<i>Mallra dhe shërbime</i>		-	-	-	-
<i>Komunali</i>		-	-	-	-
<i>Subvencione dhe transfere</i>		-	-	-	-
<i>Shpenzime Kapitale</i>		-	-	-	-
[Nënprogrami]		-	-	-	-
<i>Paga dhe mëditje</i>					
<i>Mallra dhe shërbime</i>					
<i>Komunali</i>					
<i>Subvencione dhe transfere</i>					
<i>Shpenzime Kapitale</i>					
[Nënprogrami]		-	-	-	-
<i>Paga dhe mëditje</i>					
<i>Mallra dhe shërbime</i>					
<i>Komunali</i>					
<i>Subvencione dhe transfere</i>					
<i>Shpenzime Kapitale</i>					
[Programi]		-	-	-	-
<i>Paga dhe mëditje</i>		-	-	-	-
<i>Mallra dhe shërbime</i>		-	-	-	-
<i>Komunali</i>		-	-	-	-
<i>Subvencione dhe transfere</i>		-	-	-	-
<i>Shpenzime Kapitale</i>		-	-	-	-

Pasqyrë e Financimit të Organizatës Buxhetore/Programit
Korniza Buxhetore Afatmesme (Vlerësimet e Hershme për Periudhën Aktuale)

Përshkrimi	Viti 0 (Buxheti Aktual)	Viti 1 (Vl. e Hershme)	Viti 2 (Vl. e Hershme)
Paga dhe Mëditje	851,854.00	894,446.70	939,168.34
Mallra dhe Shërbime	2,880,393.00	553,474.00	513,035.00
Komunalitet	33,740.00	33,740.00	33,740.00
Subvencione dhe transfere			
Shpenzime kapitale	200,000.00		
Gjithsej	3,965,987.00	1,481,660.70	1,485,943.34

Gjithsej kosto e iniciativës së re	Viti 0	Viti 1	Viti 2	Viti 3
Paga dhe mëditje	-	-	-	-
Mallra dhe Shërbime	-	38,449,768.00	-	-
Komunalitet	-	-	-	-
Subvencione dhe transfere	-	-	-	-
Shpenzime kapitale	-	-	-	-
Gjithsej	-	1,550,232.00	-	-
		40,000,000.00		

Burimet e Financimit	Viti 0	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Totali
Buxheti Shtesë nga KAB i Ardhshëm					
Numri i punëtorëve	-	-	-	-	-
Paga dhe mëditje	-	-	-	-	-
Mallra dhe Shërbime	-	-	-	-	-
Komunalitet	-	-	-	-	-
Subvencione dhe Transfere	-	-	-	-	-
Shpenzime Kapitale	-	-	-	-	-
Partnerët Zhvillimor (donatorët)	-	-	-	-	-
Financim nga Huamarrja	-	40,000,000.00	-	-	40,000,000.00
Tjetër (p.sh. PPP)	-	-	-	-	-
Gjithsej	-	40,000,000.00	-	-	40,000,000.00

Shënime për Financim

Plani kombëtar i Kosovës për shpërndarjen dhe vaksinimin me vaksinat kundër COVID-19, ky plan do të financohet nga burimi i financimit të huamarrjes të cilat janë pjesë e tabelave të buxhetit për vitin 2021.

[Nënprogrami]		-	-	-	-
<i>Paga dhe mëditje</i>					
<i>Mallra dhe shërbime</i>					
<i>Komunali</i>					
<i>Subvencione dhe transfere</i>					
<i>Shpenzime Kapitale</i>					
[Nënprogrami]		-	-	-	-
<i>Paga dhe mëditje</i>					
<i>Mallra dhe shërbime</i>					
<i>Komunali</i>					
<i>Subvencione dhe transfere</i>					
<i>Shpenzime Kapitale</i>					
[Nënprogrami]		-	-	-	-
<i>Paga dhe mëditje</i>					
<i>Mallra dhe shërbime</i>					
<i>Komunali</i>					
<i>Subvencione dhe transfere</i>					
<i>Shpenzime Kapitale</i>					



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave
Ministrarstvo za Financije - Ministry of Finance
Departamenti i Buxhetit-Budzet Department-Budget Department
Formularët e Vlerësimit të Ndikimit Buxhetor

Organi propozues :	Mistria e Shëndetësis	
Titulli i Nismës së Re:	Plani Kombëtar i Kosovës për shpërndarjen dhe vaksinimin me vaksinat kundër COVID-19	
Dorëzuar nga:	Administrata Qendrore	
Qëllimi i Nismes se re:	Vaksinimi i popullates me vaksinën anti COVID 19	

Objektivat e Nismes se re:

Treguesit e Efikasitetit të Produkteve:

Produkti	Viti 0			Viti 1			Viti 2			Viti 3		
	Sasia	Njësia Matëse	Kostoja për njësi	Sasia	Njësia matëse	Kostoja për njësi	Sasia	Njësia Matëse	Kostoja për njësi	Sasia	Njësia Matëse	Kostoja për Njësi
VAKSINIMI I POPULLESIS				1260000	NR	29						

Vlerësimet e Hershme për Organin Propozues/Programin sipas KAB-it aktual			
	Viti 0	Viti 1	Viti 2
Paga dhë Mëditje	851,854.00	894,446.70	939,168.34
Mallra dhe Shërbime	2,880,393.00	553,474.00	513,035.00
Komunali	33,740.00	33,740.00	33,740.00
Subvencione dhe transfere	-	-	-
Shpenzime Kapitale	200,000.00	-	-
Gjithsej	3,965,987.00	1,481,660.70	1,485,943.34

Kostoja totale	Viti 0	Viti 1	Viti 2	Viti 3
Paga dhe Mëditje	-	-	-	-
Mallra dhe Shërbime	-	38,449,768.00	-	-
Komunali	-	-	-	-
Subvencione dhe Transfere	-	-	-	-
Kapitale	-	1,550,232.00	-	-
Gjithsej	-	40,000,000.00	-	-

Burimet e Propozuara të Financimit

Buxhet Shtesë nga KAB i Ardshëm	-	-	-	-
Numri i Punetoreve	-	-	-	-
Paga dhe mëditje	-	-	-	-
Mallra dhe Shërbime	-	-	-	-
Komunali	-	-	-	-
Subvencione dhe Transfere	-	-	-	-
Shpenzime Kapitale	-	-	-	-
Partnerët Zhvillimor (donatorët)	-	40,000,000.00	-	-
KAB Ekzistues	-	-	-	-
Paga dhe mëditje	-	-	-	-
Mallra dhe Shërbime	-	-	-	-
Komunali	-	-	-	-
Subvencione dhe Transfere	-	-	-	-
Shpenzime Kapitale	-	-	-	-
Financim nga Huamarrja	-	-	-	-
Tjetër (p.sh. PPP)	-	-	-	-
Gjithsej	-	40,000,000.00	-	-

Pjesa pa financim të paraparë	-	-	-	-
-------------------------------	---	---	---	---


Komente shtesë për financim

Plani kombëtar i Kosovës për shpërndarjen dhe vaksinimin me vaksinat kundër COVID-19, ky plan do të financohet nga burimi i financimit të huamarrjes të cilat janë pjesë e tabelave të buxhetit për vitin 2021.


Më:

09/02/2021


Zyrtari Kryesor Financiar


Nënshkrimi

Zyrtari Kryesor Administrativ


Nënshkrimi

Ministri/Kreu i Organizatës


Nënshkrimi



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Ministria e Shëndetësisë
Ministarstvo Zdravstva / Ministry of Health

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës
Nacionalni Institut za Javno Zdravstvo Kosova / National Institute Public Health of
Kosova

Plani Shtetëror i Vaksinimit kundër COVID- 19

18 shkurt 2021

Faqja e miratimit

Plani Shtetëror i Imunizimit kundër COVID-19 është zhvilluar nga Komiteti për Imunizim kundër COVID-19 dhe grupit punues të themeluar dhe miratuar nga Ministria e Shëndetësisë bazuar në Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 (Ligji nr. 07/1-006).


Ky Plan është miratuar nga anëtarët e Komitetit për vaksinimin me vaksinën kundër COVID-19.

Anëtarët e Komitetit për vaksinimin me vaksinën kundër COVID-19:

Emri dhe mbiemri	Institucioni	Pozita
Edita Haxhiu	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike	Shefe e Imunizimit / Kryesuese
Pashk Buzhala	Ministria e Shëndetësisë	Zëvendëskryesues / Udhëheqës i Divizionit të Shëndetit Publik
Fetije Fetaj	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike	Epidemiologe
Ariana Kalaveshi	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike	Udhëheqëse e Departamentit të Epidemiologjisë
Sanije Xhemajli	Ministria e Shëndetësisë	Udhëheqëse e Divizionit të Monitorimit dhe Vlerësimit
Albana Morina	Ministria e Shëndetësisë	Udhëheqëse e Divizionit të Kujdesit Parësor Shëndetësor
RamushBejqi	Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar	Specialist i Pediatriisë
Lindita Ajvazaj	Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar	Specialiste e Sëmundjeve Infektive
Mirvete Kelmendi	Ministria e Shëndetësisë	Zyrtare Ligjore
Ardian Rugova	Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale	Udhëheqës i Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale
Ismet Hyseni	Ministria e Shëndetësisë	Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit
Arbnora Beka	Ministria e Shëndetësisë	Zyrtare për Farmaci
Merita Vuthaj	Ministria e Shëndetësisë	Udhëheqëse e Divizionit për Shëndetin e Nënës, Fëmijës dhe Shëndetin Riprodhues
ArbereshaTurjaka	Ministria e Shëndetësisë	Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Strategjik
Adelina Lenjani	Ministria e Shëndetësisë	Sekretare Teknike
Faik Hoti	Ministria e Shëndetësisë	Udhëheqës i Divizionit për Komunikim me Publikun
Zenel Hisenaj	Ministria e Shëndetësisë	Udhëheqës i Departamentit të Sistemit të Informimit Shëndetësor
Dafina Muçaj	Zyra e UNICEF-it në Kosovë	Zyrtare e Shëndetit dhe Ushqimit
IsmeHumolli	Zyra e OBSH-së në Prishtinë	Gatishmëria për emergjencat shëndetësore të vendit NPO & IHR

Nënshkrimet e sektorëve përkatës qeveritarë:

Znj. Edita Haxhiu, Kryesuese



Nënshkrimi

Z. Pashk Buzhala, Zëvendëskryesues


Nënshkrimi 

Tabela e përmbajtjes

Faqja e miratimit.....	2
Tabela e përmbajtjes.....	4
Përmbledhje ekzekutive.....	7
1. Hyrje.....	10
2. Gatishmëria rregulative	13
3. Planifikimi dhe koordinimi i futjes në përdorim të vaksinës.....	15
4. Burimet dhe financimi	17
5. Popullatat e synuara dhe strategjitë e vaksinimit	26
6. Menaxhimi i zinxhirit të furnizimit dhe menaxhimi i mbetjeve të kujdesit shëndetësor ...	31
4. Trajnimi dhe menaxhimi i burimeve njerëzore	40
5. Pranimi dhe marrja (kërkesa) e vaksinave	44
6. Monitorimi i sigurisë së vaksinave dhe menaxhimi i EPPV dhe sigurisë së injektimit.....	51
7. Sistemi i monitorimit të imunizimit.....	53
8. Mbikëqyrja e sëmundjes.....	54
9. Vlerësimi i futjes në përdorim të vaksinave kundër COVID-19	56
<i>Shtojca 1: Formulari i Hetimit të EPPV-ve.....</i>	<i>58</i>

Shkurtesat

EPPV	Efektet e padëshirueshme pasvaksinale
AKPPM	Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale
AM	Autorizim i Marketingut
AMF	Ambulanta e Mjekësisë Familjare
ARK	Autoriteti Rregullator Kombëtar
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi European
PZF	Pajisjet e Zinxhirit të Ftohtë
ÇPF	Çertifikata origjinale e Produkteve Farmaceutike
DQ	Depo qendrore
EMA	Agjencia Evropiane e Barnave
MEV	Menaxhimi Efektiv i Vaksinave
FDA	Agjencia Amerikane e Ushqimit dhe Barnave
FP	Fletudhëzimi i Paketimit
IFN	Institucionet Financiare Ndërkombëtare
IKShPK	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës
IPC	Parandalimi dhe kontrolli i infeksionit
QRShP	Qenrat Rajonale të Shëndetit Publik
KSNI	Komiteti për Sëmundjet Ngjitëse dhe Imunizim
LTA	Marrëveshjet aktuale afatgjata
MICS	Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë
MSh	Ministria e Shëndetësisë
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
PIE	Vlerësimi i vaksinës së re pas futjes në përdorim

PKP	Përmbledhja e Karakteristikave të Produktit
PShV	Plani Shtetëror i Vaksinim
PMP	Çertifikata e Praktikës së Mirë të Prodhimit
PPM	Pajisjet personale mbrojtëse
PSV	Procedura standarde të veprimit
PZF	Pajisjet e Zinxhirit të Ftohtë
PZI	Programi i Zgjeruar i Imunizimit
QKKTGJ	Qendra Kombëtare e Kosovës për Transfuzionin e Gjakut
QKMF	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
QZhMF	Qendra e Zhvillimi të Mjekësisë Familjare
QMF	Qendra e Mjekësisë Familjare
RTMD	Pajisjet Monitoruese në kohë Reale
SAGE	Grupi Strategjik Këshillëdhënës i Ekspertëve për Imunizim
SISH	Sistemit i Informimit Shëndetësor
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
ZUF	Zinxhir Ultra të Ftohtë
ULT	Temperaturë ultra e ulët
VCP	Projekti për Besimin ndaj Vaksinave
VRE	Ngjarje lidhur me vaksina
VSh	Vizitat në shtëpi

Përmbledhje ekzekutive

Republika e Kosovës ka bërë të gjitha përgatitjet e kërkuara për sigurimin e vaksinës kundër COVID-19. Në përputhje me *Ligjin për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19*, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës në muajin gusht të vitit 2020, institucionet përkatëse kanë koordinuar dhe planifikuar të gjitha fazat e vaksinimit, nga procedurat rregullative deri te vlerësimi pas futjes në përdorim të vaksinave.

Sa i përket procedurave rregullative, janë identifikuar rrugët për procedurat e përsheptuara të cilat do të lejojnë një shpërndarje të shpejtë kur vaksinat të jenë në dispozicion. Janë identifikuar dy procedura të përsheptuara sipas të cilave vaksinat kundër COVID-19 do të arrijnë dhe shpërndahen në vend. Së pari është "procedura e donacionit", e cila automatikisht u jep donatorëve autorizimin dhe lejen e importit për vaksinën. Procedura e dytë, e cila teorikisht mund të aplikohet për vaksinat e blera apo bashkë-financuara nga Qeveria, është aprovimi emergjent nga Ministri i Shëndetësisë, i cili automatikisht do ta pajisë prodhuesin e vaksinës me lejen për import.

Planifikimi i futjes në përdorim të vaksinës kundër COVID-19 bëhet nga "Komiteti për vaksinimin me vaksinën kundër COVID-19", i krijuar më 24 dhjetor 2020 nga Ministria e Shëndetësisë. Komiteti ka përcaktuar grupet prioritare në bazë të disponueshmërisë së vaksinave në secilën fazë specifike të vaksinimit.

Sipas planit të pasqyruar në këtë dokument të PSHV, futja në përdorim e vaksinës kundër COVID-19 do të bëhet gjatë tri fazave. Në **fazën e parë** të futjes në përdorim të vaksinës, 3% e popullsisë (apo 54,000 punëtorë shëndetësorë dhe të moshuar) do të vaksinohet. Në **fazën e dytë** – pjesa tjetër e popullsisë prej 17% (306,000 people) do të vaksinohen.

Gjatë **fazës së parë** dhe **të dytë** të futjes në përdorim të vaksinës vendi do t'i përdorë vaksinat nga mekanizimi COVAX AMC i Aleancës Gavi, ku Kosova është njëra ndër vendet e kualifikuara.

Në **fazën e tretë** të futjes në përdorim, vaksinimi do të shtrihet në pjesën tjetër prej 50% (apo 900,000 persona) të popullsisë në mënyrë që të arrijë cakun prej 70% të mbulimit me vaksinim të përcaktuar nga vendi. Gjatë gjithë procesit të futjes në përdorim do të ketë barazi në përzgjedhjen e grupeve të synuara për vaksinim dhe ofrimin e shërbimeve të vaksinimit.

Është bërë analizimi i kostos dhe financimit të PSHV. Kostot për vaksinat dhe furnizimet për injektim nuk janë marrë parasysh në analizimin e kostos për fazën e parë dhe të dytë, pasi që vaksinat dhe pajisjet për injektim që nevojiten për vaksinimin e 20% të popullsisë së përgjithshme do të jepen si donacion për vendin nëpërmjet Aleancës GAVI COVAX.

Tre skenarë të ndryshëm janë marrë parasysh për vlerësimin e kostove të vaksinës dhe furnizimeve për injektim për fazën III të futjes në përdorim të vaksinës kundër COVID-19. Përveç resurseve të kërkuara për vakcina dhe furnizime për injektim, janë vlerësuar edhe kostot e ndërlidhura me planin e shpërndarjes së vaksinës. Detajet e kostimit janë prezantuar në kapitullin 4 në faqe 13 të këtij dokumenti.

Për zbatimin e komponentëve të PShV dhe prokurimin e vaksinave për fazën e tretë të futjes në përdorim, Qeveria e Kosovës ka ndarë 40 milionë euro (apo përafërsisht 48 milionë \$ amerikanë)¹ në kuadër të buxhetit për vitin 2021 dhe Kuvendi i Kosovës e ka aprovuar këtë vendim.²

Gjatë planifikimit të futjes në përdorim të vaksinës kundër COVID-19 qeveria i ka kushtuar vëmendje të veçantë logjistikës dhe komponentës së zinxhirit të ftohtë të futjes në përdorim të vaksinës. Në muajin dhjetor të vitit 2020, Ministria e Shëndetësisë ka përfunduar vlerësimin e Pajisjeve të Zinxhirit të Ftohtë (PZF) në Kosovë, mbështetur nga zyra e UNICEF-it në Kosovë. Raporti i vlerësimit ka dhënë vlerësimet më të fundit të kapaciteteve aktuale të ruajtjes, kapacitetit të nevojshëm për zbatimin e programit të rregullt të imunizimit në Kosovë dhe rekomandimet për përmirësimin e performancës së zinxhirit të ftohtë dhe sistemeve të logjistikës në Kosovë. Sipas gjetjeve të vlerësimit, kapaciteti i sistemit të zinxhirit të ftohtë në temperaturë +2°C +8°C, si dhe kapaciteti i Zinxhirit Ultra të Ftohtë (ZUF) i sistemit të zinxhirit të ftohtë në Kosovë (apo kapaciteti në -70°C, -80°C) mjaftojnë për ruajtjen dhe shpërndarjen e vaksinave që kërkohen për imunizimin e më shumë se 60% të popullsisë së përgjithshme të vendit.

Megjithatë, duhet të bëhet zëvendësimi i pajisjeve aktuale të zinxhirit të ftohtë, pasi që zinxhiri aktual i ftohtë në Kosovë është 20 vjet i vjetër dhe nuk i përmbush rekomandimet e OBSH-së për pajisje për ruajtje të vaksinës. Zëvendësimi duhet të bëhet në të gjitha nivelet e zinxhirit të ftohtë dhe kostoja e vlerësuar për përmirësimin e zinxhirit të ftohtë arrinë vlerën në 2,291,739 \$US. Ky zëvendësim i PZF nuk do të jetë pengesë për programet ekzistuese të imunizimit, përfshirë vaksinimin me vaksinën kundër COVID-19, pasi që zëvendësimi do të jetë gradual.

Përgatitjet bëhen gjithashtu për burimet njerëzore të cilat do të angazhohen në programin e vaksinimit. Bazuar në kapacitetin ekzistues të burimeve njerëzore, Komiteti për vaksinimin me vaksinat kundër COVID-19 vlerësoi se stafi ekzistues me përvojë, i cili është i angazhuar në vaksinim në Programin Kombëtar të Vaksinimit, do të jetë i mjaftueshëm për dhënien e vaksinës kundër COVID-19, pa kompromentuar programin e rregullt të imunizimit. Për dy fazat tjera do të rritet burimet ekzistuese njerëzore, bazuar në vlerësimin e nevojave.

Sidoqoftë, një trajnim i detajuar është planifikuar bazuar në modulet e trajnimit të zhvilluara nga OBSH-ja dhe UNICEF-i për punëtorët shëndetësorë. Më shumë se një mijë epike qendrore dhe lokale të imunizimit, mjekë, infermierë, menaxherë shëndetësorë vendas, teknikë të zinxhirit të ftohtë, media dhe folës në media, do të trajnohen në disa aspekte të procesit të vaksinimit.

Futja në përdorim e vaksinave të reja gjithashtu kërkon komunikim efektiv përmes kombinimit të qasjeve të ndryshme strategjike. Për forcimin e kërkesës për vakcina dhe zbatimin e suksesshëm të programit të vaksinimit, sugjerohen disa drejtime strategjike: a) Menaxhimi i keqinformimit, b) Angazhimi i komunitetit, c) Ngritja e kapaciteteve të punëtorëve shëndetësorë, d) Komunikimi i krizave e) Gjenerimi i të dhënave dhe shpërndarja e informacionit.

Gjatë procesit të vaksinimit, monitorimi do të jetë një komponent tjetër i rëndësishëm. Për monitorimin e imunizimit, do të zhvillohet një modul i veçantë për vaksinimin kundër COVID-19 dhe do të integrohet në WebApp të Sistemit Informativ Shëndetësor (SISH). Në këtë modul, të dhënat personale të

¹ Norma e këmbimit është marrë në xe.com

²Mbuluar nëpërmjet IFN - Institucionet Financiare Ndërkombëtare

personave që marrin vaksinën do të futen në sistem në kohë reale nga profesionistët shëndetësorë në kohën e marrjes së vaksinës. Kjo do të bëjë të mundur raportimin mbi statusin e procesit të vaksinimit, bazuar në tregues të ndryshëm, të tillë si popullsia totale e vaksinuar, numri i njerëzve të vaksinuar të ndarë sipas moshës, gjinisë, komunës, etj.

Nga ana tjetër, për raportimin dhe hetimin e ngjarjeve negative pas vaksinimit (EPPV) do të përdoret *Manuali për mbikëqyrjen e EPPV* i zhvilluar nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKSHP). Hetimi EPPV-ve potenciale do të bëhet nga grupi i ekspertëve nga Ministria e Shëndetësisë, Programi Kombëtar i Imunizimit, IKSHP-ja, Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, dhe do të vëzhgohet nga OBSH-ja dhe UNICEF-i.

Në fund, gjashtë muaj pas fillimit të vaksinimit, do të kryhet një vlerësim pas futjes në përdorim të vaksinave, bazuar në udhëzimet e OBSH-së. Vlerësimi pas futjes në përdorim të vaksinave do t'ua mundësojë institucioneve të bëjnë ndryshime në sistem, në mënyrë që të përmirësojnë procesin e vaksinimit në fazat vijuese.

1. Hyrje

Informata të përgjithshme³

Kosova gjendet në Evropën Juglindore dhe ka një sipërfaqe prej 10,908 km². Kufizohet nga Shqipëria në jugperëndim, Mali i Zi në veriperëndim, Serbia në verilindje dhe Maqedonia e Veriut në jug. Vendi ka një popullsi të vlerësuar prej 1.78 milion, me 61% për qind që jetojnë në zonat rurale. Moshë mesatare e popullsisë është 30.2 vjeç, popullsia më e re në rajon.

Sipas regjistrimit të vitit 2011, popullsia e Kosovës përbëhet nga shqiptarë të Kosovës (91%), serbë të Kosovës (3.4%) dhe pakica të tjera, si boshnjakë, goranë, turqë, romë, ashkalinjë dhe egjiptianë (5.6%). Administrativisht, Kosova është e ndarë në 38 komuna me 1,469 vendbanime të organizuara sipas ligjeve të vendit.

Jetëgjatësia në Kosovë ka pasur një rritje gjatë viteve të kaluara, megjithëse mbetet ende më e ulët në rajon. Jetëgjatësia në lindje për të dy gjinitë vlerësohet në 72.1 vjet⁴, me 74.5 vjet për gratë dhe 70 vjet për burrat. Jetëgjatësia mesatare në rajonin e Ballkanit Perëndimor është 76 vjet.

Shkalla e vdekshmërisë është 4.4 ‰, me sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut si shkak kryesor i vdekjes, i ndjekur nga sëmundjet malinje⁵. Shkalla e vdekshmërisë foshnjore vlerësohet në 15 për 1,000 lindje të gjalla, ndërsa në mesin e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë është pothuajse dy herë më e lartë, e vlerësuar në 26 për 1,000 lindje të gjalla⁶. Vdekshmëria e nënave vlerësohet në 14.3 për 100,000 lindje.

Incidenca e tuberkulozit ka treguar një trend pozitiv të rënies, megjithëse akoma i pranishëm si një sëmundje ngjitëse. Shkalla e incidencës së tuberkulozit është përgjysmuar nga 85.9 në vitin 2000 në 43 në vitin 2011 (për popullsi prej 100,000)⁷.

Prevalenca aktuale e HIV mbetet e ulët në Kosovë. Shkalla e infeksionit vlerësohet të jetë më pak se 1% në popullatën e përgjithshme dhe më pak se 5% në të gjitha grupet që rrezikojnë të marrin HIV⁸. Megjithatë, statusi aktual i HIV/STI nuk është i besueshëm për shkak të mosraportimit të plotë dhe mungesës së të dhënave të sakta.

Në lidhje me imunizimin, mbulimi raportohet të jetë mbi 95%⁹, me 73 për qind të fëmijëve të moshës 24-35 muajsh që marrin të gjitha vaksinat në kalendarin e imunizimit¹⁰. Kjo normë është dukshëm më e ulët për fëmijët që jetojnë në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, me vetëm 38% të këtyre fëmijëve të vaksinuar plotësisht.

³Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK): Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës

⁴Burimi: Banka Botërore - <https://data.worldbank.org/indicator/SP.DYN.LE00.IN?locations=XK>

⁵Burimi: Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2017-2021 - https://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_sektoriale_e_shendetesise_final-nentor_2016_ENG.pdf

⁶MICS 2019-2020 për Kosovën - <https://www.unicef.org/kosovoprogramme/media/1936/file/MICS%20Snapshots%20.pdf>

⁷Burimi: Programi Kombëtar i Imunizimit | Plani Gjithëpërfshirës Shumëvjeçar 2017-2020

⁸Burimi: Programi Kombëtar i Imunizimit Plani Gjithëpërfshirës Shumëvjeçar 2017-2020

⁹<https://msh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2019/07/Plani-i-Imunizimit-07.06.2019-lik.pdf>

¹⁰Burimi: Anketat e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë (MICS) 2020

Institucionet e kujdesit shëndetësor në Kosovë janë të organizuara në tri nivele: parësor, dytësor dhe tretësor. Rrjeti publik i kujdesit parësor shëndetësor përbëhet nga gjithsej 429 institucione, nga të cilat secila komunë ka Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) si njësinë kryesore¹¹. Shërbimet e kujdesit shëndetësor dytësor ofrohen nga gjashtë spitale rajonale të vendosura në qytetet kryesore të Kosovës, ndërsa kujdesi shëndetësor tretësor sigurohet nga Qendra Klinike Universitare, e vendosur në Prishtinë. Përveç institucioneve shëndetësore publike, kujdesi shëndetësor në Kosovë ofrohet edhe nga mbi 1 mijë institucione mjekësore private të licencuara, nga të cilat 28 janë institucione spitalore.

Sistemi i kujdesit shëndetësor në Kosovë financohet kryesisht nga taksat dhe bashkëpagesat. Shpenzimet nga xhepi konsiderohen të jenë ndër më të lartat në rajon, me 40% të shpenzimeve totale të kujdesit shëndetësor.

COVID-19 në Kosovë

Më 11 mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetësisë vlerësoi se COVID-19, një sëmundje e shkaktuar nga një koronavirus i ri (SARS-CoV-2), mund të kategorizohet si një pandemi, bazuar në nivelet e përhapjes dhe ashpërsisë së sëmundjes¹². Mbi 2 milionë vdekje nga COVID-19 janë raportuar globalisht, nga rreth 94 milion raste të konfirmuara me virus¹³.

Dy rastet e para me COVID-19 në Kosovë u konfirmuan më 13 mars. Në të njëjtën ditë, Qeveria ndërmori disa masa kufizuese për të parandaluar përhapjen e COVID-19, të tilla si mbyllja e kufijve tokësorë për shtetasit jokosovarë, pezullimi i përkohshëm i të gjitha fluturimeve të Aeroportit të Prishtinës dhe mbyllja e kafeneve, lokaleve të natës, restoranteve dhe qendrave tregtare¹⁴. Më 15 mars, Qeveria shpalli gjendjen emergjente të shëndetit publik.

Numri më i lartë i rasteve të reja ditore në Kosovë u regjistrua në nëntor, gjë që çoi në një grup të ri të masave kufizuese, të cilat janë ende në fuqi. Komunitatet janë klasifikuar si me rrezik të ulët, të mesëm ose të lartë, në varësi të numrit të banorëve të infektuar me COVID-19. Bazuar në këtë klasifikim, komunitetet kanë masa të ndryshme duke përfshirë orarin e kufizuar të punës për bizneset, si dhe një orë policore të detyrueshme ndërmjet orës 20:00-05:00 në komunitetet me rrezik të lartë. Masa të tjera të tilla si maska në hapësirat publike dhe ndalimi i tubimeve publike mbetën në fuqi.

Numri i përgjithshëm i vdekjeve nga COVID-19 ishte 1,498 deri në fund të muajit dhjetor 2020 dhe numri i rasteve të konfirmuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike në Kosovë (IKSHPK) që nga fillimi i pandemisë ishte 60 mijë. Numri aktual i rasteve aktive në vend është pesë mijë.

Ashtu si në vendet e tjera, pandemia gjithashtu ka prekur ekonominë e Kosovës. Banka Botërore parashikoi një rënie ekonomike prej 8.8 për qind për vitin 2020¹⁵. Masat kufizuese, kufizimet ndërkombëtare të udhëtimit dhe pasiguria e lartë e investimeve janë faktorët kryesorë që lidhen me COVID-19 e që ndikuan në tkurrjen ekonomike.

¹¹ Burimi: Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2017-2021 - https://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_sektoriale_e_shendetesise_final-mentor_2016_ENC.pdf

¹² Burimi: Organizata Botërore e Shëndetësisë. (OBSH) - <https://www.who.int/news/item/29-06-2020-covidtimeline>

¹³ Burimi: Paneli për COVID-19 i Organizatës Botërore të Shëndetësisë - <https://covid19.who.int/>

¹⁴ Burimi: Qeveria e Kosovës

¹⁵ Burimi: Banka Botërore: Raporti i Rregullt Ekonomik për Ballkanin Perëndimor nr. 18 - <https://openknowledge.worldbank.org/bitstream/handle/10986/34644/1/53774.pdf>

Mësimet e nxjerra nga gripit A H1N1 dhe aktivitete të tjera përkatëse

Gjatë gripit A H1N1, OBSH-ja dhuroi 500,000 doza. Ministrisë së Shëndetësisë iu caktua përgjegjësia për shpërndarjen e vaksinave dhe menaxhimin e përgjithshëm të procesit. Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik realizoi aktivitetet përgatitore dhe mbështetjen teknike për vaksinim. Nuk janë mbajtur trajnime specifike, pasi që për vaksinimin kundër gripit A H1N1 nuk janë kërkuar kushte të veçanta. Plani i veprimit për zbatimin e vaksinimit është zhvilluar paraprakisht.

Lidhur me vaksinën kundër gripit sezonal, vaksinimi zakonisht fillon në fund të shtatorit dhe përfundon në dhjetor. Kërkesat janë zakonisht më të larta se numri i vaksinave të siguruara dhe vaksinimi i ofruar. Sidoqoftë, për vitin 2020, Kosova rriti numrin e vaksinave të prokuruar të gripit sezonal në 165,000 doza, ose 60% më shumë se në vitet e mëparshme. Prokurimi i vaksinave është bërë nëpërmjet Mekanizmit të Prokurimit të UNICEF-it.¹⁶Përkundër vëllimit të rritur të punës, Kosova ka zbatuar me sukses të gjitha aktivitetet e vaksinimit pa e rrezikuar programin e imunizimit rutinë.

Hera e fundit kur u fut në përdorim një vaksinë ishte në vitin 2014, me vaksinën hemophilusinfluenzae B. Komiteti për Sëmundjet Infektive dhe Imunizimin rekomandoi futjen në përdorim të vaksinës së re. Rekomandimet u bazuan në shqyrtimin e kapacitetit teknik dhe përfitimet epidemiologjike të futjes në përdorim të vaksinës.

¹⁶ Burimi Banka Botërore: Raporti i Rregullt Ekonomik për vendet e Ballkanit Perëndimor Nr. 13 - <https://openknowledge.worldbank.org/bitstream/handle/10986/34644/153774.pdf>

2. Gatishmëria rregullative

Rregullat dhe procedurat për prodhimin, kontrollin e cilësisë, regjistrimin, autorizimin për marketing, importin, farmakovigjilencën, hulumtimet klinike dhe mbikëqyrjen e produkteve dhe pajisjeve medicinale në Kosovë përcaktohen në *Ligjin për produkte dhe pajisje medicinale*. Autoriteti kompetent për produktet dhe pajisjet medicinale për përdorim njerëzor është Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale (AKPPM), ekuivalente e Autoritetit Rregullator Kombëtar (ARK).

Vendimi i AKPPM-së për dhënien Autorizimit të Marketingut (AM) për produktet medicinale bazohet në Udhëzimin Administrativ për Autorizimin e Marketingut, i miratuar në vitin 2015.

Ky dokument parasheh një **procedurë të thjeshtuar për dhënien e Autorizimit të Marketingut**, në të cilën nuk kërkohet dorëzimi i dosjes së pavarur dhe të plotë të produktit medicinal për autorizim. Sipas këtij udhëzimi, çdo mbajtës i një produkti medicinal të autorizuar nga autoritetet rregullative brenda Bashkimit Evropian (BE) dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA) ka të drejtë të aplikojë për Autorizim të Marketingut.

Dokumentet e nevojshme në këtë procedurë janë:

1. Dëshmi e pagesës për autorizim të marketingut
2. Çertifikata origjinale e Produkteve Farmaceutike (ÇPF)
3. Çertifikata e Praktikës së Mirë të Prodhimit ÇPM)
4. Përmbledhja e Karakteristikave të Produktit (PKP)
5. Fletudhëzimi i Paketimit (FP)
6. Modelimi i paketimit në alfabetin latin ose në gjuhët zyrtare të Kosovës
7. Dëshmia e statusit të autorizimit të një produkti medicinal nga autoritetet rregullative në BE ose SHBA

Për situata të emergjencave shëndetësore, mungesa e produkteve medicinale në treg, situatat katastrofale (epidemitë dhe katastrofat natyrore), *Ligji për Produkte dhe Pajisje Medicinale* parasheh një procedurë të përshpejtuar për importimin e produkteve medicinale. Në këto situata, AKPPM-ja është e autorizuar që, me miratimin e Ministrit të Shëndetësisë, të japë licencë importi për një sasi dhe lloj të caktuar produkti medicinal dhe me një afat të caktuar kohor, pa autorizim marketingu.

Opsioni shtesë për procedura të përshpejtuara rregullative parashihet në nenin 40 të *Ligjit për produkte dhe pajisje medicinale*, i cili rregullon pranimin dhe importimin e produkteve medicinale si donacione. Sipas këtij ligji, Komisioni për Donacionet e Produkteve Medicinale, i cili funksionon në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë, bazuar në PSV-në e veçantë, është përgjegjës dhe i autorizuar për t'i shqyrtuar kërkesat për donacione dhe për t'i rekomanduar Ministrisë së Shëndetësisë t'i miratojë këto kërkesa. Sipas PSV-së, për të qenë të pranueshme për donacion, produktet medicinale duhet të jenë të autorizuar nga Agjencia Evropiane e Barnave (EMA) ose FDA-ja. Leja e importit për produktet i jepet automatikisht organizatës donatore pas miratimit të kërkesës së saj nga Ministria e Shëndetësisë.

Këto procedura kryhen brenda 2-3 ditësh pune. Megjithatë, duke marrë parasysh rëndësinë e vaksinës kundër COVID-19 për shëndetin publik, Ministria do ta jep lejen e mësipërme brenda 24 orësh.

Produktet medicinale që i nënshtrohen këtyre procedurave të përshpejtuara (donacion apo nëpërmjet vendimit të Ministrisë së Shëndetësisë), nuk i nënshtrohen rregullave të Autorizimit të Marketingut dhe nuk kërkohen teste lokale para importimit, shpërndarjes dhe futjes së vaksinës në përdorim. Sipas Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, nuk kërkohet ndryshimi i etiketimit për produktet medicinale që janë pranuar si donacione apo produkte emergjente, sikur që zakonisht kërkohet për të gjitha produktet e pranuar nëpërmjet procedurave rutinë.

Vaksinat dhe furnizimet për injektim të pranuar Gavi COVAX AMC do të importohen dhe shpërndahen në vend sipas procedurës së donacionit të paraparë në nenin 40 të Ligjit për Produkte dhe Pajisje Medicinale (duke pasur parasysh që vaksinat i janë dhuruar vendit pa kërkesa për bashkëfinancim). Kjo do të mundësojë shpërndarje të shpejtë të këtyre vaksinave, duke shmangur kështu çdo vonesë të panevojshme në procesin e vaksinimit.

Qeveria e Kosovës ka shprehur gatishmërinë për nënshkrimin e marrëveshjes së dëmshpërblimit me prodhuesit e vaksinave nëpërmjet nënshkrimit të Pjesës A dhe Pjesës B të kërkesës për vakcina më 7 dhjetor dhe 14 dhjetor 2020.

Nga ana tjetër, për vaksinat e tjera, ose në rastet kur Qeveria merr pjesë në ndarjen e kostos (siç është cekur në kërkesën për vaksinë të dorëzuar te GAVI), ose në raste të tilla si blerjet e drejtpërdrejta nga prodhuesit e vaksinave - Ministri i Shëndetësisë do të japë miratimin siç përcaktohet në nenin 39 të ligjit të sipërpërmendur. Kjo do ta pajisë automatikisht prodhuesin e vaksinave me lejen për import.

Shqyrtimi i kornizës legislative më lart tregon qartë që nuk ka barriera dhe/ose kufizime për importimin e përshpejtuar të vaksinave kundër COVID-19 në vend. E njëjta vlen për vaksinat që do të shpërndahen si donacion dhe për vaksinat që do të blihen nga qeveria.

3. Planifikimi dhe koordinimi i futjes në përdorim të vaksinës

Futja në përdorim e vaksinave të reja

Zbatimi i programit kombëtar të imunizimit në Kosovë rregullohet përmes *Ligjit për Shëndetin Publik, i miratuar në vitin 2008*. Sipas këtij ligji, rekomandimet për futjen në përdorim të vaksinave të reja në vend përgatiten dhe jepen nga Komiteti për Sëmundjet Ngjitëse dhe Imunizim (KSNI) për Ministrinë e Shëndetësisë. KSNI-ja përbëhet nga përfaqësuesit e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik dhe të institucioneve të tjera përkatëse. Rekomandimet për futjen në përdorim të vaksinave të reja bazohen në standardet ndërkombëtare dhe treguesit epidemiologjikë. Vendimi përfundimtar për futjen në përdorim të vaksinave të reja në vend merret nga Ministria e Shëndetësisë. Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik është përgjegjës për zbatimin e vendimeve të MSH-së, si dhe planifikon dhe zbaton të gjitha aktivitetet në lidhje me futjen në përdorim të vaksinave të reja.

Futja në përdorim e vaksinës kundër COVID-19

Në vitin 2020, qeveria rishikoi procedurën për futjen në përdorim të vaksinës dhe krijoi një procedurë të re për futjen në përdorim të vaksinës kundër COVID-19, e cila dallon nga procedura standarde për futjen e vaksinave të reja në programin e rregullt rutinë të imunizimit.

Tri organe institucionale janë funksionale dhe ndërlidhen me COVID-19. I pari është Bordi Këshilldhënës për COVID-19 i përbërë nga ekspertë shëndetësorë, i cili i ofron Ministrinë të Shëndetësisë rekomandime të pavarura për çështjet e ndërlidhura me COVID-19. Ky bord e ka rekomanduar Ministrinë e Shëndetësisë për futjen në përdorim të vaksinës kundër COVID-19, si intervenim i madh për kontrollimin e pandemisë COVID-19. Ky rekomandim është në përputhje me *Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e pandemisë COVID-19*, të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës në muajin gusht të vitit 2020, i cili e bën MSH përgjegjëse për sigurimin e vaksinës dhe Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik (IKSHP) përgjegjës për kryerjen e vaksinimit.

Organi i dytë institucional është grupi teknik i krijuar nga Ministria e Shëndetësisë në muajin nëntor të vitit 2020. Ky grup teknik ka anëtar nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik (IKSHP), Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave, UNICEF-i dhe OBSH-ja. Ky grup është përgjegjës për përcaktimin e nevojave për vaksinën kundër COVID-19, duke përcaktuar dhe identifikuar grupet prioritare për vaksinim dhe duke hartuar dokumentet e ndërlidhura me vaksinën kundër COVID-19.

Organi i tretë relevant institucional i krijuar për vaksinën kundër COVID-19 është Komiteti për Vaksinim me Vaksinën kundër COVID-19 (ekuivalent me NITAG), i krijuar në muajin dhjetor të vitit 2020. Ky komitet kryesohet nga Udhëheqësi i Programit të Zgjeruar të Imunizimit (PZI) dhe ka 17 anëtarë, të cilët përfaqësojnë disa organizata kombëtare dhe ndërkombëtare, si Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, MSH, Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, UNICEF-i dhe OBSH-ja. Roli kyç i këtij Komiteti është koordinimi i vaksinimit me COVID-19.

Komponentët e PSHV do të zbatohen nëpërmjet një qasjeje multi-sektoriale. Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik do të jetë përgjegjës për zbatimin e programit në nivel kombëtar, ndërsa komponenta për ofrimin e shërbimeve do të zbatohet në nivelin komunal, nga Kujdesi Parësor Shëndetësor (KPSH).

Zinxhiri i furnizimit do të menaxhohet nga menaxheri i IKSHP për zinxhirin e furnizimit. Menaxheri do ta mbikëqyr zinxhirin e ftohtë në KPSH dhe vendet tjera të vaksinimit. Stoku i vaksinave dhe mallrave të thata do të menaxhohet nga zyrtari i logjistikës në IKSHP.

Do të përfshihen edhe akterë tjerë në faza të ndryshme të vaksinimit. Për shembull, trajnimi i ekipeve të vaksinimit do të realizohet me mbështetjen e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh-së) dhe UNICEF-it.

Arsyetimi dhe kriteret për prioritizim

Komiteti për Vaksinim me Vaksinën kundër COVID-19 ka përcaktuar kriteret specifike për prioritizimin e grupeve të synuara për vaksinim për futjen në përdorim të COVID-19. Këto kriteret janë përcaktuar në bazë të rekomandimeve globale të dhëna nga OBSh/SAGE. Konkretisht, këto kriteret bazohen në dy dokumente:

1. Korniza e vlerave e OBSh SAGE për ndarjen dhe prioritizimin e vaksinimit kundër COVID-19¹⁷, dhe
2. Udhërrëfyesi i OBSh SAGE për prioritizimin e përdorimeve të vaksinave kundër COVID-19 në kontekst të furnizimit të kufizuar¹⁸.

Sipas vendimit të Komitetit, futja në përdorim e vaksinës kundër COVID-19 do të bëhet gjatë tri fazave:

Faza I – vaksinimi i grupeve me rrezik të lartë që përbëhet nga punëtorët shëndetësorë, banorët dhe punëtorët shëndetësorë të shtëpive të kujdesit për të moshuarit, grupmoshat 80+ dhe një pjesë e popullsisë me sëmundje kronike. Numri i përgjithshëm i grupit të parë prioritar të synuar është 54,000 individë, i cili përbënë 3% të popullsisë së përgjithshme të vendit.

Faza II – grupi i synuar në fazën 2 të futjes në përdorim të vaksinës kundër COVID-19 do të përbëjë 17% të popullsisë së përgjithshme dhe do t'i përfshijë grupmoshat 65-79, popullsinë e mbetur me sëmundje kronike, mësimdhënësit dhe forcat e sigurisë të përfshira në menaxhimin e pandemisë COVID-19.

Faza III – gjatë fazës 3, e cila është e fundit, PSHV parasheh vaksinimin e 50% të popullsisë në mënyrë që të arrijë 70% të mbulimit të përgjithshëm të popullsisë me vaksinën COVID-19.

Informacione të detajuara lidhur me mënyrën e ofrimit të shërbimeve dhe fazat e zbatimit janë dhënë në seksionin përkatës të këtij plani (shih seksionin 5 të PSHV).

¹⁷<https://www.who.int/publications/i/item/who-sage-values-framework-for-the-allocation-and-prioritization-of-covid-19-vaccination>

¹⁸ <https://www.who.int/publications/i/item/who-sage-values-framework-for-the-allocation-and-prioritization-of-covid-19-vaccination>

4. Burimet dhe financimi

Burimet financiare për vakcina

Në total 70% e popullsisë, apo 1,260,000 persona, do të synohen për vaksinim me vaksinë kundër COVID-19 gjatë zbatimit të të gjitha tri fazave të futjes në përdorim të vaksinës kundër COVID-19. Vaksinat për imunizimin e pjesës së parë të popullsisë prej 20% (grupeve më të rrezikuara) do të sigurohen nëpërmjet Aleancës COVAX AMC, ku Kosova është në mesin e 92 vendeve të kualifikuara. Prandaj, kostot e vaksinave të përdorura në fazat I dhe II të vaksinimit kundër COVID-19 nuk janë përfshirë në vlerësimin e kërkesave për resurse për zbatimin PSHV, pasi që këto vakcina do t'i dhurohen vendit.

Vaksinat për pjesën tjetër të popullsisë prej 50%, apo 900,000 persona, janë përfshirë në vlerësimet e kostos, pasi që këto vakcina do të prokurohen nga qeveria nëpërmjet marrëveshjeve bilaterale me prodhuesit apo shitësit palë të treta.

Tabela 1 dhe

Tabela 2 në faqen 18 dhe Tabela në faqen 49 paraqesin tre skenarë të ndryshëm të vlerësimeve të kostos për zbatimin e fazës III. Për krijimin e këtyre skenarëve janë marrë kostot indikative të vaksinave nga Paneli i UNICEF-it për Tregun e Vaksinës kundër COVID-19. Vlerësimet janë bërë në bazë të supozimit që mbulimi i synuar me vaksinim do të jetë 95% dhe caku i humbjes do të jetë 10%.

Për vaksinimin e 50% të popullsisë gjatë fazës III kërkohen gjithsej 2,660,000 doza vakcine.

Detajet e skenarëve janë paraqitur më poshtë:

Skenari I – për vaksinimin e pjesës tjetër të popullsisë prej 50% qeveria i përdor vaksinat për të cilat nevojitet kapacitet me temperaturë pozitive të zinxhirit të ftohtë (në +2°C-+8°C). Kostoja totale e vaksinave sipas këtij skenari do arrijë vlerën prej 5,147,157\$ amerikanë.

Skenari II – për zbatimin e fazës III, qeveria i përzgjedh vaksinat për të cilat nevojitet temperatura -20°C (lloji i vaksinës Moderna). Kostoja totale e vaksinave për vaksinimin e 50% të popullsisë së përgjithshme do të arrijë vlerën prej 42,305,400 \$ amerikanë.

Skenari III – për vaksinimin e 50% të popullsisë së përgjithshme gjatë fazës III – vakcina e përdorur për vaksinim kërkon Zinxhir Ultra të Ftohtë në -70°C. Sipas këtij skenari, kërkesat për burime për prokurimin e vaksinave do të arrijnë vlerën në 34,549,410 \$ amerikanë.

Vlerësimet e mësipërme të kostos janë indikative dhe mund të ndryshohen, varësisht nga marrëveshjet bilaterale.

Përveç kostove të vaksinave, kostoja e furnizimit të materialeve shpenzuese për vakcina gjithashtu është llogaritur për dy skenarë të ndryshëm: skenari me vaksinën për të cilën nuk nevojitet hollues dhe vaksinën për të cilën nevojitet hollues. Vlerësimi i kostos për skenarin e parë (I) është 1,474,793 \$ amerikanë, ndërsa për vlerësimin e kostos për skenarin e dytë (II) është 1,387,920 \$ amerikanë (shih tabelën e mëposhtme).

Vlerësimi i përgjithshëm i kostos për zbatimin e të gjithë komponentëve të këtij PSHV është 2,841,531 \$ amerikanë.

Qeveria e Kosovës ka ndarë 40 milionë euro (apo përafërsisht 48 milionë dollarë amerikanë) në buxhetin e vitit 2021 për prokurimin e vaksinave kundër COVID-19 dhe zbatimin e komponentëve të PSHV, duke përfshirë: menaxhimin e zinxhirit të furnizimit, menaxhimin dhe trajnimin e burimeve njerëzore, pranimin dhe marrjen e vaksinën, mbikëqyrjen e EPPV, monitorimin dhe mbikëqyrjen e sëmundjes dhe vlerësimin e futjes në përdorim të vaksinës kundër COVID-19. Vendimi i qeverisë është miratuar nga Kuvendi i Kosovës.

Tabela 1. Kostimi i skenarit 1: faza 1 dhe 2 – vaksinat e dhuruara nga Aleanca Gavi COVAX dhe zbatimi i fazës 3 me vaksinën për të cilën nevojitet kapacitet i ruajtjes me temperaturë pozitive (në +2°C +8°C)

Faza	Grupi i synuar	Madhësia e grupit të synuar	Caku i mbullimit	Personat e vaksinuar	Dozat e planifikuara	Caku i humbjes	Faktori i humbjes	# i dozave te nevojshme (prfsh. Humbjen)	Vaksina	Cmimi për dozë	Cmimi për dozë/ngarkuar	Gjithsej kostoja (në \$US)	
3.00%	1 Te gjithë punëtorët shëndetësorë	13,500	95%	12,825	2	10%	1.111	28,500	AstraZeneca/AZD1222	-	-	-	COVAX DONATION
	1 Banorët në shtëpitë e pleqve dhe punëtorët socialë	1,249	95%	1,187	2	10%	1.111	2,637	AstraZeneca/AZD1222	-	-	-	
	1 Grupmosha mbi 80 vjeç	33,000	95%	31,350	2	10%	1.111	69,667	AstraZeneca/AZD1222	-	-	-	
	1 Një pjesë e personave me sëmundje kronike	6,251	95%	5,938	2	10%	1.111	13,197	AstraZeneca/AZD1222	-	-	-	
17%	2 Grupmosha 65-79	133,348	95%	126,681	2	10%	1.111	281,512	AstraZeneca/AZD1222	-	-	-	COVAX DONATION
	2 Pjesa e mbetur e personave me sëmundje kronike	135,439	95%	128,667	2	10%	1.111	285,927	AstraZeneca/AZD1222	-	-	-	
	2 Mësimdhënësit	33,310	95%	31,645	2	10%	1.111	70,321	AstraZeneca/AZD1222	-	-	-	
	2 Forcat e sigurisë	3,903	95%	3,708	2	10%	1.111	8,240	AstraZeneca/AZD1222	-	-	-	
50%	3 Grupmosha 40-64	332,925	95%	316,279	2	10%	1.111	702,842	AstraZeneca/AZD1222	2.19	2.71	1,904,019	GOVT PROCUREMENT
	3 Popullata me sëmundje të tjera	96,009	95%	91,209	2	10%	1.111	202,686	AstraZeneca/AZD1222	2.19	2.71	549,082	
	3 Punëtorët e sektorit publik	14,853	95%	14,110	2	10%	1.111	31,356	AstraZeneca/AZD1222	2.19	2.71	84,945	
	3 Pjesa tjetër e popullsisë	456,213	95%	433,402	2	10%	1.111	963,116	AstraZeneca/AZD1222	2.19	2.71	2,609,111	
Totali		1,260,000		1,197,000				2,660,000				5,147,157	

Tabela 2. Kostimi i skenarit 2: faza 1 dhe 2 – vaksinat e dhuruara nga Aleanca Gavi COVAX dhe zbatimi i fazës 3 me vaksinat të cilat duhet të ruhen në temperaturë -20°C

Faza	Grupi i synuar	Madhësia e grupit të synuar	Caku i mbullimit	Personat e vaksinuar	Dozat e planifikuara	Caku i humbjes	Faktori i humbjes	# i dozave te nevojshme (prfsh. Humbjen)	Vaksina	Cmimi për dozë	Cmimi për dozë/ngarkuar	Gjithsej kostoja (në \$US)	
3.00%	1 Te gjithë punëtorët shëndetësorë	13,500	95%	12,825	2	10%	1.111	28,500	AstraZeneca/AZD1222	-	-	-	COVAX DONATION
	1 Banorët në shtëpitë e pleqve dhe punëtorët socialë	1,249	95%	1,187	2	10%	1.111	2,637	AstraZeneca/AZD1222	-	-	-	
	1 Grupmosha mbi 80 vjeç	33,000	95%	31,350	2	10%	1.111	69,667	AstraZeneca/AZD1222	-	-	-	
	1 Një pjesë e personave me sëmundje kronike	6,251	95%	5,938	2	10%	1.111	13,197	AstraZeneca/AZD1222	-	-	-	
17%	2 Grupmosha 65-79	133,348	95%	126,681	2	10%	1.111	281,512	AstraZeneca/AZD1222	-	-	-	COVAX DONATION
	2 Pjesa e mbetur e personave me sëmundje kronike	135,439	95%	128,667	2	10%	1.111	285,927	AstraZeneca/AZD1222	-	-	-	
	2 Mësimdhënësit	33,310	95%	31,645	2	10%	1.111	70,321	AstraZeneca/AZD1222	-	-	-	
	2 Forcat e sigurisë	3,903	95%	3,708	2	10%	1.111	8,240	AstraZeneca/AZD1222	-	-	-	
50%	3 Grupmosha 40-64	332,925	95%	316,279	2	10%	1.111	702,842	Moderna/mRNA-1273	18	22.27	15,649,473	GOVT PROCUREMENT
	3 Popullata me sëmundje të tjera	96,009	95%	91,209	2	10%	1.111	202,686	Moderna/mRNA-1273	18	22.27	4,512,999	
	3 Punëtorët e sektorit publik	14,853	95%	14,110	2	10%	1.111	31,356	Moderna/mRNA-1273	18	22.27	698,180	
	3 Pjesa tjetër e popullsisë	456,213	95%	433,402	2	10%	1.111	963,116	Moderna/mRNA-1273	18	22.27	21,444,748	
Totali		1,260,000		1,197,000				2,660,000				42,305,400	

Tabela 3. Kostimi i skenarit 3: faza 1 dhe 2 – vaksinat e dhuruara nga Aleanca Gavi COVAX dhe zbatimi i fazës 3 me vaksinë për të cilat nevojitet kapacitet ZUF (në 70°C –80°C)

Faza	Grupi i synuar	Madhësia e grupit të synuar	Caku i mbulimit	Personat e vaksinuar	Dozat e planifikuara	Caku i humbjes	Faktori i humbjes	# i dozave te nevojshme (prfsh. Humbjen)	Vaksina	Cmimi për dozë	Cmimi për dozë/ngarkuar	Gjithsej kostoja (në \$US)	
3.00%	1 Te gjithë punëtorët shëndetësorë	13,500	95%	12,825	2	10%	1.111	28,500	AstraZeneca/AZD1222	-	-	-	COVAX DONATION
	1 Banorët në shtëpitë e pleqve dhe punëtorët socialë	1,249	95%	1,187	2	10%	1.111	2,637	AstraZeneca/AZD1222	-	-	-	
	1 Grupmosha mbi 80 vjeç	33,000	95%	31,350	2	10%	1.111	69,667	AstraZeneca/AZD1222	-	-	-	
	1 Një pjesë e personave me sëmundje kronike	6,251	95%	5,938	2	10%	1.111	13,197	AstraZeneca/AZD1222	-	-	-	
17%	2 Grupmosha 65-79	133,348	95%	126,681	2	10%	1.111	281,512	AstraZeneca/AZD1222	-	-	-	COVAX DONATION
	2 Pjesa e mbetur e personave me sëmundje kronike	135,439	95%	128,667	2	10%	1.111	285,927	AstraZeneca/AZD1222	-	-	-	
	2 Mësimdhënësit	33,310	95%	31,645	2	10%	1.111	70,321	AstraZeneca/AZD1222	-	-	-	
	2 Forcat e sigurisë	3,903	95%	3,708	2	10%	1.111	8,240	AstraZeneca/AZD1222	-	-	-	
50%	3 Grupmosha 40-64	332,925	95%	316,279	2	10%	1.111	702,842	Pfizer/BioNTech/BNT-162	14.70	18.18	12,780,403	GOVT PROCUREMENT
	3 Popullata me sëmundje të tjera	96,009	95%	91,209	2	10%	1.111	202,686	Pfizer/BioNTech/BNT-162	14.70	18.18	3,685,616	
	3 Punëtorët e sektorit publik	14,853	95%	14,110	2	10%	1.111	31,356	Pfizer/BioNTech/BNT-162	14.70	18.18	570,180	
	3 Pjesa tjetër e popullsisë	456,213	95%	433,402	2	10%	1.111	963,116	Pfizer/BioNTech/BNT-162	14.70	18.18	17,513,211	
Totali		1,260,000		1,197,000				2,660,000				34,549,410	

Tabela 4: Resurset e kërkuara për pajisje dhe furnizime për injektim për vaksinat për të cilat nevojitet kapacitet i ruajtjes +2°C +8°C

Artikulli	# e artikujve	Kostoja e njësisë	Nën-totali i artikujve	Shpenzimet e përgjithshme	Totali
# e shiringave AD marrë parasysh humbjet	1,795,500	0.06	107,686	29,829	137,516
# e kutive të sigurisë 5 litra	22,444	0.41	9,284	2,572	11,855
Gjithsej PPM			599,225	165,985	765,211
<i>Maskë kirurgjikale</i>	68,400	0.06	4,353	1,206	5,558
<i>Mburojë mbrojtëse/sasia</i>	34,200	1.36	46,636	12,918	59,555
<i>Numri i njësisive/dorëza</i>	3,420,000	0.15	507,818	140,666	648,484
<i>Mantele/sasia</i>	34,200	1.18	40,418	11,196	51,614
Tjera			84,982	23,540	108,522
<i>Tamponë/sasia</i>	7,182,000	0.01	43,527	12,057	55,584
<i>Ngjitës/sasia</i>	1,710,000	0.009	15,545	4,306	19,852
<i>Kartelat e vaksinimit/sasia</i>	855,000	0.03	25,909.09	7,177	33,086
Gjithsej resurse				\$221,926	1,023,103

Tabela 5: Resurset e kërkuara për pajisje dhe furnizime për injektim për vaksinat për të cilat nevojitet kapacitet i ruajtjes ZUF (në -70°C -80°C)

Artikulli	# e artikujve	Kostoja e njësisë	Nën-totali i artikujve	Shpenzimet e përgjithshme	Totali
# e shiringave AD marrë parasysh humbjet	1,795,500	0.06	107,686	29,829	137,516
Shiringat 5ml për hollim Msls/YF	359,100	0.02	7,617	2,110	9,727
Hollues/NaCl 0.9%	342,000	0.07	23,836	6,603	30,439
Akull i thatë	8,964	1.21	10,866	3,010	13,875
# e kutive të sigurisë 5 litra	22,444	0.41	9,284	2,572	11,855
Gjithsej PPM			599,225	165,985	765,211
Maskë kirurgjikale	68,400	0.06	4,353	1,206	5,558
Mburojë mbrojtëse/sasia	34,200	1.36	46,636	12,918	59,555
Numri i njësisë/dorëza	3,420,000	0.15	507,818	140,666	648,484
Mantele/sasia	34,200	1.18	40,418	11,196	51,614
Tjera			84,982	23,540	108,522
Tamponë/sasia	7,182,000	0.01	43,527	12,057	55,584
Ngjitës/sasia	1,710,000	0.009	15,545	4,306	19,852
Kartela e vaksinimit/sasia	855,000	0.03	25,909.09	7,177	33,086
Gjithsej resurset				\$233,649	1,077,145

Tabela 6: Vlerësimi i buxhetit për PSHV

Aktiviteti	Përshkrimi	Kostoja totale	Burimi i financimit	Faza 1	Faza 2	Faza 3
1. Strategjitë e vaksinimit	Përshkrimi	Kostoja totale (dollarë amerikanë)	Burimi			
1.1 Përshtatja e vendit të vaksinimit	Kostot operacionale për inventarizimin, ngrohjen e hapësirës	70,000	Ministria e Shëndetësisë	10,000	60,000	
2. Menaxhimi i zinxhirit të furnizimit dhe menaxhimi i mbejeteve nga kujdesi shëndetësor	Përshkrimi	Kostoja totale	Burimi i financimit	Faza 1	Faza 2	Faza 3
2.1. Pajisjet e Zinxhirit të Ftohtë (PZF)	Zëvendëson PZF-të e vjetërsuara dhe rrit kapacitetin e ruajtjes për të akomoduar vaksinat e planifikuara të reja dhe pandemike dhe kapacitetin e ruajtjes ndërkombëtare transit në aeroport.	943,800	Financim nga Ministria e Financave/IFN			
2.2. Mbështetja për servisin dhe mirëmbajtjen e PZFPZF	Mirëmbajtja, servisi dhe pjesët rezervë për 5 vjet pas lëshimit të garancisë nga prodhuesi.	198,000	Financim nga Ministria e Financave/IFN			
2.3. Sistemi i menaxhimit të të dhënave për temperaturën e vaksinës	Siguron një panel kontrolli për gjurmimin e menaxhimit dhe mirëmbajtjes së temperaturës në kohë reale për të gjitha vendet e ruajtjes së vaksinave në Kosovë për 5 vjet	150,000	Financim nga Ministria e Financave/IFN			
2.4. Ndërtimi i depozitës së re qendrore të vaksinave	Siguron hapësirë të mjaftueshme për të instaluar pajisjet e kërkuara të dhomës së ftohtë dhe inventarizimin e mallrave të thata për vaksinat rutinë dhe për pandeminë	497,232	Financim nga Ministria e Financave/IFN			
2.5. Shërbime të reja të depozitës qendrore të vaksinave	Siguron furnizim të besueshëm dhe të qëndrueshëm të energjisë elektrike, shërbime të energjisë elektrike dhe hidraulike, pajisje për paketimin e vaksinave dhe trajtimin e stoqeve, sigurinë nga zjarri, sistemin e pastrimit dhe kullimit	91,159	Financim nga Ministria e Financave/IFN			
2.6. Ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore	Ngrit kapacitetet e burimeve njerëzore për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e Pajisjeve të Zinxhirit të Ftohtë (PZFPZF)	79,000	Financim nga Ministria e Financave/IFN			
2.7 Transport në frigorifer për IKSHPK-në rajonale (7)	Kamioneta frigoriferë për të siguruar mbledhjen dhe dërgimin e sigurt dhe të shpejtë të vaksinave, veçanërisht të vaksinave kundër COVID-19.	154,000	Financim nga Ministria e Financave/IFN			
2.8 Transport në frigorifer për IKSHPK-në qendrore	Kamionë frigoriferë për të siguruar mbledhjen dhe dërgimin e sigurt dhe të shpejtë të vaksinave, veçanërisht të vaksinave kundër COVID-19.	38,000	Financim nga Ministria e Financave/IFN			

Aktiviteti	Përshkrimi	Kostoja totale	Burimi i financimit	Faza 1	Faza 2	Faza 3
3. Human resources management and training	Description	Total Cost	FundingSource	Phase 1	Phase 2	Phase 3
3.1. Trajnimi i punëtorëve shëndetësorë të përfshirë në imunizim dhe mbikëqyrje	300 ofrues dhe mbikëqyrës të shërbimeve	27,000	Faza e parë e mbuluar nga GAVI AT/UNICEF. Faza të tjera nga financimi i Ministrisë së Shëndetësisë / IFN.	1500	10500	15000
3.2. Përshatja dhe printimi i materialit trajnues	Përshatja e pakos trajnuese të OBSH-së dhe shërbimet e printimit	1,300	Faza e parë e mbuluar nga GAVI AT/UNICEF	500	300	500
4. Monitorimi i sigurisë së vaksinave dhe menaxhimi i EPPV-ve dhe sigurisë së injektimit	Përshkrimi	Kostoja totale	Burimi i financimit	Faza 1	Faza 2	Faza 3
4.1. Trajnime për zyrtarët e caktuar të cilët do të kryejnë monitorimin dhe menaxhimin e EPPV-ve	114 anëtarë personeli të përzgjedhur do të trajnohen për 2 ditë vetëm në menaxhimin e EPPV	9,120	Mbuluar nga GAVI AT/OBSH			
4.2. Materiali i operimit dhe trajnimit	Shërbimet e printimit	300	Mbuluar nga GAVI AT/OBSH			
4.3. Asistenca Teknike Ndërkombëtare për mbikëqyrjen dhe monitorimin e EPPV-ve	Tarifa e ekspertit ndërkombëtar / 10 ditë (vendosja e një sistemi të shëndoshë të mbikëqyrjes bazuar në udhëzimet e OBSH-së)	6,000	Mbuluar nga GAVI AT/OBSH			
5. Sistemi i monitorimit të imunizimit	Përshkrimi	Kostoja totale	Burimi i financimit	Faza 1	Faza 2	Faza 3
5.1. Zhvillimi i modulit (aplikim në internet) brenda Sistemit të Informacionit Shëndetësor	AT për zhvillimin e modulit COVID-19 brenda SMISH	10,000	Mbuluar nga GAVI AT / UNICEF dhe financim nga Ministria e Shëndetësisë / IFN			
5.2. Trajnimi i personelit të përfshirë në futjen e të dhënave për imunizim	78 anëtarë personeli për fazën 1 të trajnuar për futjen e të dhënave për 1 ditë; 126 të trajnuar për fazën 2; 630 të trajnuar për fazën 3	11,220	Financim shtesë i Ministrisë së Financave / IFN	1020	1360	5100
5.3. Blerja e pajisjeve të TI-së	Laptopë për futjen e të dhënave për fazën 1 dhe fazën 2 në vendet e përkohshme të imunizimit; printer për printimin e kartave.	109,200	Financim shtesë i Ministrisë së Financave / IFN	9200	24000	76000
5.4. Printimi i materialeve/Kartat e imunizimit	Shërbime printimi	378,000	Financim shtesë i Ministrisë së Financave / IFN	1500	106500	270000
6. Vlerësimi i futjes në përdorim të vaksinave kundër COVID-19	Përshkrimi	Kostoja totale	Burimi i financimit	Faza 1	Faza 2	Faza 3

Aktiviteti	Përshkrimi	Kostoja totale	Burimi i financimit	Faza 1	Faza 2	Faza 3
6.1. Trajnimi i vlerësuesve	1 konsulent ndërkombëtar / 2 ditë	1,200	Financim shtesë i Ministrisë së Financave / IFN			
6.2. Përshatja, finalizimi dhe printimi i pyetësorëve	30 faqe	1,000	Financim shtesë i Ministrisë së Financave / IFN			
6.3. Puna në terren dhe futja e të dhënave, takime me ekipet vlerësuese, diskutimi i gjetjeve kryesore dhe shtjellimi i rekomandimeve	10 ditë, 10 vlerësues / 50 Euro tarifë	5,000	Financim shtesë i Ministrisë së Financave / IFN			
6.4. Analiza e të dhënave dhe zhvillimi i raportit	14 ditë / tarifë për konsulent ndërkombëtar	8,400	Financim shtesë i Ministrisë së Financave / IFN			
7. Pranimi dhe marrja (kërkesa) e vaksinave	Përshkrimi	Kostoja totale	Burimi i financimit	Faza 1	Faza 2	Faza 3
7.1 Formimi i iniciativës së Dëgjimit Social dhe Përfshirjes Digjitale	Trajnimi, gjenerimi dhe publikimi i raporteve	13,000	Financim shtesë i Ministrisë së Financave / IFN			
7.2. Angazhimi i ndikuesve të ndryshëm të komunitetit	Angazhimi i udhëheqësve fetarë, pakicave etnike, ekspertëve për të promovuar vaksinimin përmes aktiviteteve të shtrirjes në terren (ang. "outreach")	10,000	Financim shtesë i Ministrisë së Financave / IFN			
7.3. Promovimi i vaksinimit në mesin e popullatave të synuara përmes programit të vizitave në shtëpi (VSh)	Trajnimi i infermierëve të vizitave në shtëpi mbi komunikimin për vaksinat kundër COVID-19; materiale për shpërndarje	5,000	Financim shtesë i Ministrisë së Financave / IFN			
7.4. Zhvillimi i materialeve të komunikimit dhe informimit për të mbështetur komunikimin e punonjësve shëndetësorë me marrësit e vaksinave	Zhvillimi, dizajnimi dhe printimi i materialeve informuese	4,000	Financim shtesë i Ministrisë së Financave / IFN			
7.6. Zhvillimi i materialeve të komunikimit për të informuar publikun mbi lansimin e vaksinimit, efektivitetin e vaksinës, priorizimin e grupeve etj.	Zhvillimi i videove, transmetimeve, dizajneve dhe printimit të materialeve të tjera të C4D	20,000	10,000 mbuluar nga GAVI AT/UNICEF			
7.7. Zhvillimi dhe zbatimi i planit të veprimit të komunikimit në krizë që përcakton hapa të qartë për t'u ndjekur në përgjigje të efekteve eventuale të lidhura me vaksinën dhe efekteve anësore pas imunizimit	Konsulent lokal për zhvillimin e mbështetjes për 5 ditë / tarifa për një ditë 120 Euro	600	Financim shtesë i Ministrisë së Financave / IFN			
TOTALI		\$ 2,841,531				

5. Popullatat e synuara dhe strategjitë e vaksinimit

Komiteti për vaksinat COVID-19 ka përcaktuar grupet prioritare, bazuar në rekomandimet globale për përzgjedhjen e grupeve të synuara, disponueshmërinë e vaksinave dhe mundësitë ekzistuese të vendit për sigurimin e vaksinave COVID-19 përmes marrëveshjeve dypalëshe.

Sipas vendimeve të Komitetit, vaksinimi do të kryhet në tre faza:

- Gjatë fazës së parë, synohet vaksinimi i përafërsisht 3% të popullsisë së përgjithshme të vendit.
- Gjatë fazës së dytë, synohet vaksinimi i 17% të popullsisë; dhe
- Gjatë fazës së tretë, synohet vaksinimi i 50% të popullsisë së përgjithshme të vendit. Në këtë mënyrë, sipas planit të qeverisë, gjithsej 70% e popullsisë së përgjithshme do të mbrohet nga COVID-19.

Vendimi për caktimin e prioriteteve është në linjë me udhërrëfyesin e Grupit Strategjik Këshillëdhënës të Ekspertëve për Imunizim (SAGE) në kuadër të OBSH-së për caktimin e prioriteteve të datës 13 nëntor 2020¹⁹. Konkretisht, ky vendim bazohet në strategji e përcaktuar në udhërrëfyes, që thotë se "kur furnizimet me vakcina janë shumë të kufizuara, ajo që mund të arrihet me sasinë e kufizuar të vaksinave në dispozicion arsyeton fokusin fillestar në uljen e drejtpërdrejtë të sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë si dhe mirëmbajtjen e shërbimeve kritike më thelbësore, duke marrë parasysh reciprocitetin ndaj grupeve që i nënshtrohen rreziqeve joproporcionale për t'i zbutur pasojat e kësaj pandemie (për shembull, punonjësit shëndetësorë në vijën e parë të frontit)".

Faza e parë e vaksinimit

Katër nëngrupet e mëposhtme janë identifikuar për vaksinimin gjatë fazës së parë së vaksinimit kundër COVID-19:

- Të gjithë punëtorët shëndetësorë;
- Banorët në shtëpitë e pleqve dhe tërë punonjësit socialë;
- Grup moshë mbi 80 vjeç;
- Personat me sëmundje kronike;

Numri i përgjithshëm i grupit të synuar në Fazën e parë është 54,000 (ose 3% e popullsisë së përgjithshme të vendit).

Vaksinimi i grupeve të synuara në Fazën e parë do të kryhet në nivelin qendror dhe rajonal. Në nivelin qendror, vaksinimi do të administrohet në Qendrën e Zhvillimit të Mjekësisë Familjare (QZHMf) me seli në Prishtinë në kampusin e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, ku ekziston hapësirë e mjaftueshme për t'i akomoduar 6 ekupe vaksinimi. Në nivelin rajonal vaksinimi do të kryhet në objektet e

¹⁹Burimi: Udhërrëfyesi i SAGE-s së OBSH-së për dhënien e përparësisë gjatë përdorimit të vaksinave kundër COVID-19 në rast të furnizimit të kufizuar - <https://www.who.int/docs/default-source/immunization/sage/covid/sage-prioritization-roadmap-covid19-vaccines.pdf>

Instituteve Rajonale të Shëndetit Publik në gjashtë qytetet më të mëdha. Vaksinimi brenda objekteve ekzistuese të kujdesit shëndetësor ka përparësi sa i përket menaxhimit të rasteve me EPPV, për shkak të afërsisë së këtyre vendeve me njësitë emergjente.

Kohëzgjatja e Fazës së parë do të jetë 20 ditë dhe gjatë të gjitha seancave të vaksinimit do të sigurohet zbatimi i të gjitha masave për parandalimin dhe kontrollin e infektimit (IPC).

Vaksinimi i banorëve dhe punonjësve socialë në shtëpitë e të moshuarve do të kryhet nga ekipet mobile.

Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet barazisë në shpërndarjen e vaksinave. Rreth 11,000 doza vaksinash do t'i dedikohen vaksinimit të 5,400 punonjësve shëndetësorë dhe të moshuarve (10% e popullsisë që vaksinohen në Fazën e parë) në 10 komuna me shumicë serbe. Strategjia e shpërndarjes së vaksinave për këto komuna është e njëjtë me komunat tjera. Detajet mbi strategjitë e vaksinimit dhe grupet me përparësi janë paraqitur në Tabelen 7.:

Tabela 7: Grupet e synuara dhe strategjitë e vaksinimit për Fazën e parë të vaksinimit

faza	Popullsia e synuar (sipas prioritetit)	Numri i individëve ²⁰	% totale kumulative e vaksinave si përqindje e popullsisë	Strategjia e shpërndarjes	Vendet e vaksinimit
FAZA 1	1. Të gjithë punëtorët shëndetësorë	13,500	0.7%	Vend i përkohshëm	Qendra e Zhvillimit të Mjekësisë Familjare (QZhMF) dhe 6 Institutet Rajonale të Shëndetit Publik (IRShP)
	2. Banorët në shtëpitë e pleqve dhe tërë punonjësit socialë	1,249	0.06%	Klinikë mobile	Vaksinimi do të kryhet nga ekipet mobile në shtëpitë e pleqve.
	3. Grup moshë mbi 80 vjeç	33,000	1.8%	Vend i përkohshëm	Qendra e Zhvillimit të Mjekësisë Familjare (QZhMF) dhe 6 IRShP-të
	4. Personat me sëmundje kronike (persona në dializë, persona me diabet, sëmundje kardiovaskulare)	6,251	0.3%	Vend i përkohshëm	Qendra e Zhvillimit të Mjekësisë Familjare (QZhMF) dhe 6 IRShP-të
Gjithsej në Fazën e parë		54,000	3%		

Nëse dërgesa e parë e dozave nuk do të jetë e mjaftueshme për t'i përfshirë gjithë personat e fazës së parë, përparësi do t'i jepet atyre nën-grupeve të popullatës sipas renditjes në këtë tabelë.

Ekipet e vaksinimit do të përbëhen nga tre persona, një mjek/e, një infermier/e dhe një vullnetar/e nga Fakulteti i Mjekësisë (student/e i/e vitit të fundit) dhe puna në vendet e vaksinimit do të organizohet në dy ndërrime, ku ndërrimi i parë do të punojë nga ora 07:00 deri 13:00 dhe ndërrimi i dytë nga ora 13:30 deri 19:30.

²⁰ Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, Ministria e Shëndetësisë, Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik

Për çdo ndërrim do të jetë i pranishëm ekipi emergjent (me automjete të ndihmës së shpejtë). Përveç kësaj, furnizimi me kompletin e ndihmës së shpejtë do të sigurohet për secilin ekip vaksinimi në vendin e vaksinimit. Do të bëhet prokurimi për kompletet e ndihmës së shpejtë dhe atë në të gjitha vendet e imunizimit.

Gjithashtu, para vaksinimit, do të sigurohet trajnim i veçantë për secilin ekip në lidhje me menaxhimin e reaksioneve të anafilaksisë dhe zbatimin e masave kundër anafilaksisë të cilat do të integrohen gjatë zhvillimit të trajnimit me ekipet e vaksinimit.

Temat e trajnimit do të përfshijnë:

- Vlerësimin e përfitimit të rrezikut për personat me reaksion alergjik historik ndaj çfarëdo vaksine tjetër ose terapie me injektim
- Përcaktimin e llojit dhe ashpërsisë së reagimit dhe besueshmërisë së informatave
- Vëzhgimin e personave me reaksion alergjik
- Trajtimin e anafilaksisë
- Veprimet anësore dhe masat paraprake të vaksinës COVID-19 Pfizer/ BioNTech.

Çdo ndërrim do ta ketë ekipin për përcjelljen e procesit të përbërë nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik dhe Ministria e Shëndetësisë. Gjithashtu, përfaqësues nga Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe UNICEF-i, që herë pas here do të qëndrojnë në vendet e vaksinimit.

Gjatë vaksinimit, do të zbatohen masat detyruese për parandalimin e përhapjes së virusit. Këto masa të detyrueshme janë:

- Pajisjet e detyrueshme personale mbrojtëse (PPM) për ekipet e vaksinimit gjatë gjithë ndërrimit
- Maska të detyrueshme për personat që do të vaksinohen
- Dezinfektues dhe maska shtesë në secilin kënd vaksinimi
- Të paktën 10 minuta pritje ndërmjet çdo vaksinimi
- Dezinfektimi i tërë vendit të vaksinimit pas çdo ndërrimi, nga kompania e kontraktuar nga MSH-ja
- Numri i personave në hapësirën e pritjes mos ta kalojë numrin maksimal të personave që lejohet me masa parandaluese të rekomanduara nga IKSHP-ja dhe MSH-ja.

Sa i përket pajisjeve personale mbrojtëse, aktualisht në dispozicion gjendet sasi e mjaftueshme të PPM për ta mbuluar vaksinimin kundër COVID-19 dhe programet tjera që kanë të bëjnë me shëndetin. Përveç kësaj, furnizimi me PPM sigurohet rregullisht nga MSH-ja dhe donatorët.

Aktualisht në stok gjenden këto PPM:

- Maska kirurgjikale - 1,300,000
- Maska FP2 dhe KN95 - 17,000
- Doreza mbrojtëse - 194,000

- Mbueroja fytyre - 14,000.

Faza e dytë e vaksinimit

Gjatë fazës së dytë të vaksinimit, synohet vaksinimi i 17% të popullsisë së përgjithshme të vendit.

Ekzistojnë katër grupe të identifikuara si grupe me prioritet për Fazën e dytë, në përputhje me rekomandimet e SAGE të OBSH-së. Tabela paraqet informatat e hollësishme për grupet kryesore të synuara gjatë Fazës së dytë të vaksinimit.

Tabela 8: Grupet e synuara dhe strategjia e vaksinimit për Fazën e dytë të vaksinimit

	Popullsia e synuar (sipas rendit të përparësisë)	Numri i individëve ²¹	% totale kumulative e vaksinave si përqindje e popullsisë	Strategjia e shpërndarjes	Vendet e vaksinimit
FAZA 2	Grup moshë 65-79 vjeç	133,348	7.4%	Vend i përkohshëm	Qendra e Zhvillimit të Mjekësisë Familjare (QZhMF) dhe 6 Institutet Rajonale të Shëndetit Publik (IRShP)
	Personat e mbetur me sëmundje kronike	135,439	7.5%	Vend i përkohshëm	Qendra e Zhvillimit të Mjekësisë Familjare (QZhMF) dhe 6 IRShP-të
	Mësuesit	33,310	1.87%	Vend i përkohshëm	Qendra për Zhvillimin e Mjekësisë Familjare (QZhMF) dhe 6 IRShP-të
	Forcat e sigurisë të përfshira drejtpërdrejt në menaxhimin e COVID-19	3,903	0.21%	Vend fiks	Objektet e Policisë së Kosovës dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës
Gjithsej në Fazën e dytë		306,000	17%		

Vaksinimi gjatë kësaj faze do të bëhet në shtatë vende (lokalitete): në Qendrën e Zhvillimit të Mjekësisë Familjare në kryeqytetin Prishtinë, dhe në Institutet Rajonale të Shëndetit Publik të gjashtë rajoneve (Pejë, Mitrovicë, Gjakovë, Gjilan dhe Ferizaj). Në anën tjetër, për forcat e sigurisë vaksinimi do të kryhet në objektet ekzistuese shëndetësore të Policisë së Kosovës dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Faza e tretë e vaksinimit

Gjatë fazës së tretë të vaksinimit, afërsisht 50% e popullsisë së përgjithshme do të synohen, që do ta arrijë shkallën e përgjithshme të mbulimit me vakcina COVID-19 deri në 70% të popullsisë së përgjithshme. Qëllimi i qeverisë është rritja e mbulimit gradual të vaksinimit ashtu që ta mbulojë gjithë popullatën.

Grupet e synuara të identifikuara për këtë fazë sipas renditjes në bazë të prioritetit janë: grup moshë 40-64 vjeç - 332.925 (18.4%); Popullsia e mbetur me kushte të theksuara shëndetësore 96,009 (5.3%); punëtorët e sektorit publik 14,853 (0,82%), dhe popullsia e mbetur (grup moshë 17-39 vjeç).

Vaksinimi në fazën e tretë do të organizohet në të gjitha institucionet e kujdesit shëndetësor parësor në 38 komunat e vendit, ku ofrohen shërbimet e rregullta të imunizimit.

²¹Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, Ministria e Shëndetësisë, Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik

Table 9: Target groups and vaccination strategies during the Phase III of vaccine introduction

FAZA 3	Popullsia e synuar (sipas rendit të përparësisë)	Numri i individëve ²²	% totale kumulative e vaksinave si përqindje e popullsisë	Strategjia e shpërndarjes	Vendet e vaksinimit
	Grup moshë 40-64 vjeç	332,925	18.4%	Vend fiks	Objekti i Kujdesit Parësor Shëndetësor
	Popullsia e mbetur me kushte të theksuara shëndetësore	96,009	5.3%	Vend fiks	Objekti i Kujdesit Parësor Shëndetësor
	Punëtorët e sektorit publik	14,853	0.8%	Vend fiks	Objekti i Kujdesit Parësor Shëndetësor
	Popullsia e mbetur	456,213	25.5%	Vend fiks	Objekti i Kujdesit Parësor Shëndetësor
Gjithsej në Fazën 3	900,000	50%			

²²Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, Ministria e Shëndetësisë, Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik


4. Menaxhimi i zinxhirit të furnizimit dhe menaxhimi i mbetjeve të kujdesit shëndetësor

Menaxhimi i zinxhirit të furnizimit

Pajisjet e zinxhirit të ftohtë të Kosovës në nivelin qendror dhe në institucionet shëndetësore janë pjesë thelbësore e zinxhirit të furnizimit për imunizim dhe luajnë rol kritik në reagimin ndaj pandemisë COVID-19. Nuk është bërë asnjë vlerësim për Menaxhimin Efektiv të Vaksinave (EVM) në Kosovë gjatë 5 viteve të fundit. Sidoqoftë, në dhjetor 2020 Ministria e Shëndetësisë përfundoi vlerësimin e Pajisjeve të Zinxhirit të Ftohtë (PZF) në Kosovë, mbështetur nga zyra e UNICEF në Kosovë. Raporti i vlerësimit parasheh kapacitetet aktuale të ruajtjes për programin e rregullt të imunizimit dhe vaksinën kundër COVID-19 dhe rekomandime për përmirësimet të kërkuara kryesore në fuqizimin e shërbimeve të imunizimit përfshirë ruajtjen dhe shpërndarjen e vaksinave në kuadër të reagimit ndaj pandemisë.

Raporti i vlerësimit është menaxhuar nga Zyra e UNICEF-it në Kosovë me mbështetje teknike dhe udhëheqje nga grupi punues i themeluar nga Ministria e Shëndetësisë, më përbërje të përfaqësuesve të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike, Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut të Kosovës dhe Organizatës Botërore të Shëndetësisë. Të gjitha të dhënat e ofruara për zinxhirin e ftohtë të vaksinave dhe menaxhimin e furnizimit bazohen në Vlerësimin e Pajisjeve të Zinxhirit të Ftohtë në Kosovë; Përforcimin e sistemit të vaksinimit në Kosovë; Gatishmërinë për vaksinën kundër COVID-19.


Porti i hyrjes	Aeroporti Ndërkombëtar i Kosovës Adem Jashari është aeroporti i vetëm ndërkombëtar në Kosovë. Ndodhet 15 km në jugperëndim të Prishtinës, qytet ky ku ndodhet depoja qendrore e vaksinave.																								
Pikat e ruajtjes dhe kapacitetet e ruajtjes	<p>Të gjitha dërgesat ndërkombëtare të vaksinave kundër COVID-19 do të ruhen fillimisht në depon qendrore të vaksinave ku ka kapacitet neto të mjaftueshëm ruajtjeje për kërkesat e ruajtjes për vaksinat rutinë dhe SIA për ta ruajtur çdo vaksinë kundër COVID-19 deri në 20% të popullsisë së përgjithshme. Kosova ka 7 frigoriferë me ngrirje, secili me kapacitet afërsisht 600 litra, të cilët mund të vihen menjëherë në dispozicion për t'i ruajtur vaksinat Pfizer/BioNTech për më shumë se 60% të popullsisë së përgjithshme.</p> <p>Një përmbledhje e hapësirës neto të ruajtjes të kërkuar dhe në dispozicion në 2-8°C, -15 në -25°C dhe -60 në -86°C. tregohet më poshtë</p>																								
	<div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div data-bbox="351 1512 941 1904"> <p style="text-align: center;">Storage capacity at National Store</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Temperature Range</th> <th>Available (litres)</th> <th>Required (litres)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>+2°C to +8°C</td> <td>15,515</td> <td>7,933</td> </tr> <tr> <td>-25°C to -15°C</td> <td>4,988</td> <td>89</td> </tr> <tr> <td>-80°C to -60°C</td> <td>3,990</td> <td>2,216</td> </tr> </tbody> </table> </div> <div data-bbox="941 1512 1532 1904"> <p style="text-align: center;">Storage capacity at National Store</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Temperature Range</th> <th>Available (litres)</th> <th>Required (litres)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>+2°C to +8°C</td> <td>15,515</td> <td>7,933</td> </tr> <tr> <td>-25°C to -15°C</td> <td>4,988</td> <td>4,434</td> </tr> <tr> <td>-80°C to -60°C</td> <td>3,990</td> <td>0</td> </tr> </tbody> </table> </div> </div>	Temperature Range	Available (litres)	Required (litres)	+2°C to +8°C	15,515	7,933	-25°C to -15°C	4,988	89	-80°C to -60°C	3,990	2,216	Temperature Range	Available (litres)	Required (litres)	+2°C to +8°C	15,515	7,933	-25°C to -15°C	4,988	4,434	-80°C to -60°C	3,990	0
Temperature Range	Available (litres)	Required (litres)																							
+2°C to +8°C	15,515	7,933																							
-25°C to -15°C	4,988	89																							
-80°C to -60°C	3,990	2,216																							
Temperature Range	Available (litres)	Required (litres)																							
+2°C to +8°C	15,515	7,933																							
-25°C to -15°C	4,988	4,434																							
-80°C to -60°C	3,990	0																							



2-8°C Covid-19 vaccine stored at Central Store

Kosova ka zinxhir të ftohtë 3 nivelësh, ku Qendrat Kryesore Mjekësore Familjare (QKMF) në secilën prej 32 komunave ofrojnë nivelin e dytë për ruajtjen e vaksinave. 32 QKMF-të kanë kapacitet të mjaftueshëm për t'i ruajtur vaksinat kundër COVID-19 në **2-8°C, ose -15 deri -25°C**, krahas vaksinave rutinë dhe SIA. QKMF-të nuk kanë kapacitet ruajtjeje në -60 deri në -86°C. Vaksinat Pfizer/BioNTech do të transportohen tutje nga depoja qendrore e vaksinave në kutitë e dërgesave Pfizer të rimbushura me akull të thatë në sasi që i përgjigjet kërkesave specifike për seancat e planifikuara të imunizimit me vaksinën kundër COVID-19. Asnjë QKMF nuk është më larg se disa orë rrugë larg depos qendrore të vaksinave. Një përmbledhje e hapësirës në dispozicion neto për ruajtje të kërkuar dhe të njohur në **2-8°C, dhe -15 deri -25°C** në depot e QKMF-ve tregohet më poshtë:

Informatat për kapacitetin në dispozicion të ruajtjes dhe funksionimin e duhur të PZF në objektet e QKMF-ve do të rishikohen para se të dërgohen vaksinat COVID-19.



	<p style="text-align: center;">QKMF storage capacity at -25°C to -15°C</p> <p style="text-align: center;">■ Available ■ Required</p>
<p>Kapaciteti i transportit</p>	<p>Depoja qendrore e vaksinave ka transport adekuat për grumbullimin e vaksinave të imunizimit rutinë dhe mallrat e thata nga Aeroporti Ndërkombëtar Adem Jashari. Të njëjtat automjete do të përdoren për t'i grumbulluar vaksinat kundër COVID-19, holluesit sipas nevojës dhe mallrat e thata. Vëllimi i vaksinave kundër COVID-19 të transportuara për popullatën e synuar prej 20% nuk do të kalojë 13m³ dhe mallrat e thata 79m³.</p> <p>Secila komunë bën transportin për grumbullimin dhe shpërndarjen e vaksinave dhe mallrave të thata. Asnjë komunë përveç asaj të Prishtinës nuk ka kërkesë për të transportuar më shumë se 10% të vëllimit kombëtar të vaksinave ose mallrave të thata. Nuk ka kufizime në vëllim ose në disponueshmëri për transportimin e vaksinave në objektet e QKMF-ve. Kapaciteti ekzistues i transportit do të rritet përmes prokurimit të 7 automjeteve për rajone dhe 1 automjetit për depon qendrore të vaksinave.</p>
<p>Objektet rezervë</p>	<p>Kosova ka depo rezervë për ruajtjen e ftohtë të të gjitha llojeve të vaksinave kundër COVID-19 në Prishtinë ku depoja qendrore farmaceutike ka 63 m³ kapacitet bruto për ruajtje në hapësirë të ftohtë dhe 13 m³ kapacitet bruto të hapësirës së ngrirjes. Përveç kësaj, Kosova ka 7 frigorifere me ngrirje secili përafërsisht me 600 litra kapacitet, të cilët janë menjëherë në dispozicion për t'i ruajtur vaksinat Pfizer/BioNTech për më shumë se 60% të popullatës së përgjithshme. Ekzistojnë edhe kapacitete rezervë në nivelet komunale për vaksinat, pjesërisht për shkak të hapësirës së tepërt të ruajtjes që është në dispozicion për vaksinat 2-8°C në QKMF dhe për shkak të hapësirës së vogël gjeografike të Kosovës ku vaksinat mund të transportohen brenda disa orësh nga çdo komunë përsëri në depon qendrore.</p>

Për menaxhimin e pajisjeve të zinxhirit të ftohtë, Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik do ta shfrytëzojë stafin e vet ekzistues. IKSH-ja ka një menaxher i cili është përgjegjës për menaxhimin e zinxhirit të ftohtë, menaxhimin e rezervave të vaksinave dhe përcjelljen e shpërndarjes së rezervave të vaksinave. Përveç kësaj, IKSH-ja ka një zyrtar të logjistikës përgjegjës për logjistikën. Nga ana tjetër, pajisjet me zinxhir të ftohtë në nivelin komunal menaxhohen nga ekipet e vaksinimit nga programi i rregullt i imunizimit. I gjithë ky staf po trajnohet për ruajtjen dhe trajtimin e vaksinave COVID-19, si pjesë e trajnimit të përgjithshëm të ofruar për personelin shëndetësor dhe personelin tjetër (për më shumë detaje mbi trajnimin, shih Seksionin 5).

Lidhur me sigurinë e zonave ku ruhen vaksinat, të gjitha masat e kërkuara në Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik janë vendosur. Hapësirat ku ruhen vaksinat janë të kyçura me dryna specialë dhe vetëm dy persona nga IKSH-ja kanë qasje në këto hapësira.

Boshllëqet, sfidat dhe zgjidhjet për të përfunduar dislokimin e vaksinave para datës së fillimit të vaksinimit

Shpërndarja e vaksinave COVID-19 dhe mallrave të thatë do të jetë e kufizuar në furnizimin nga depoja qendrore e vaksinave në Prishtinë në 38 komunitat që ofrojnë shërbime imunizimi në objektet e QKMF-së. Popullsia e përgjithshme prej 1.78 milion banorësh, dendësia mesatare e popullsisë prej 167 banorësh/km², sistemi i decentralizuar për menaxhimin e transportit dhe rrjeti i mirë i komunikimit zvogëlon hapësirën për sfida sa i përket shpërndarjes së furnizimeve.

Procesi i shpërndarjes do t'i ndjekë, në një farë mase, praktikën e tanishme rutinë të imunizimit, ku QKMF-të identifikojnë popullatat e synuara si dhe nevojat, përgatitin planet e seancave, paraqesin kërkesë në deponë qendrore të vaksinave dhe dërgojnë automjetin për ta marrë sasi për dozën e parë të vaksinës që ta administrojë në popullatën e synuar të planifikuar. Ky proces i shpërndarjes do të përsëritet 3-4 javë më vonë për përgatitjen e administrimit të dozës së dytë. Shpërndarja e vaksinave COVID-19 për fazën e parë të vaksinimit do të bëhet vetëm nga niveli qendror. Për fazën e dytë do të shpërndahet në shtatë rajone të Kosovës ndërsa për fazën e tretë do të shpërndahet ngjashëm si për vaksinat tjera rutinë të imunizimit. Vaksinat Pfizer/ BioNTech do të shpërndahen në kutitë transportuese Pfizer të ripaketuara me akull të thatë të prodhuar në vend, vaksinat tjera COVID-19 do të transportohen në kuti të ftohta siç praktikohet në programin rutinë të imunizimit. Regjistruarit e të dhënave të temperaturës do t'i përcjellin të gjitha vaksinat e shpërndara, dhe të dhënat e temperaturës së dërgesave dhe depos do të raportohen në IKSHP.

Përmbledhje e vëllimeve, dozave dhe artikujve ndihmës që do të shpërndahen sipas zonave.

Vëllimet e vaksinave dhe artikujve ndihmës ndryshojnë për Pfizer dhe vaksinat tjera për shkak të holluesve dhe kutive transportuese që nevojiten për transportin e vaksinave Pfizer dhe ndryshimeve në vëllimet e vaksinave të paketuara. Tabelat në vijim paraqesin vëllimet e vaksinave dhe artikujve ndihmës për secilin prej dy llojeve për 3 rastet e popullsisë së synuar.

Pfizer / BioNTech

SC level	Facility	population	number of COVID doses (2 per person)			volume of vaccine (litres)			volume of diluent (litres)			volume of dry goods (litres)		
			0.25%	3%	20%	0.25%	3%	20%	0.25%	3%	20%	0.25%	3%	20%
PR	IKSHPK - Qendër	1,840,929	9,205	110,456	736,372	16.5	197.7	1318.1	27.6	331.4	2209.1	697.7	8373.0	55819.8
LD	QKMF-PRISHTINË	257,143	1,286	15,429	102,857	2.3	27.6	184.1	3.9	46.3	308.6	97.5	1169.5	7797.0
LD	QKMF-PODULJEVË	87,071	435	5,224	34,528	0.8	9.4	62.3	1.3	15.7	104.5	33.0	396.0	2640.1
LD	QKMF-DRENAS	73,643	368	4,419	29,457	0.7	7.9	52.7	1.1	13.3	88.4	27.9	334.9	2233.0
LD	QKMF-LIPJAN	61,429	307	3,686	24,572	0.5	6.6	44.0	0.9	11.1	73.7	23.3	279.4	1862.6
LD	QKMF-OBILIQ	23,571	118	1,414	9,428	0.2	2.5	16.9	0.4	4.2	28.3	8.9	107.2	714.7
LD	QKMF-F.KOSOVE	42,857	214	2,571	17,143	0.4	4.6	30.7	0.8	7.7	51.4	16.2	194.9	1296.5
LD	QKMF-PRIZREN	192,143	961	11,529	76,857	1.7	20.6	137.6	2.9	34.6	230.6	72.8	873.9	5826.1
LD	QKMF-MAMUŠHË	5,357	27	321	2,143	0.0	0.6	3.6	0.1	1.0	6.4	2.0	24.4	162.4
LD	QKMF-MALISHEVË	86,429	432	5,186	34,572	0.8	9.3	61.9	1.3	15.6	103.7	32.8	393.1	2620.7
LD	QKMF-DRAGASH	20,714	104	1,243	8,286	0.2	2.2	14.6	0.3	3.7	24.9	7.9	94.2	628.1
LD	QKMF-THERANDE	63,657	319	3,831	25,543	0.6	6.9	45.7	1.0	11.5	76.5	24.2	290.4	1936.2
LD	QKMF-RAHOVEÇ	49,500	248	2,976	19,800	0.4	5.3	35.4	0.7	8.9	59.4	18.8	225.1	1500.9
LD	QKMF-MITROVICË	80,714	404	4,843	32,286	0.7	8.7	57.8	1.2	14.5	96.9	30.6	367.1	2447.4
LD	QKMF-VUSHTRRI	77,357	387	4,641	30,943	0.7	8.3	55.4	1.2	13.9	92.8	29.3	351.8	2345.6
LD	QKMF-SKENDERAJ	63,071	265	3,184	21,228	0.5	5.7	38.0	0.8	9.6	63.7	20.1	241.4	1609.2
LD	QKMF-PEJË	83,714	419	5,023	33,486	0.7	9.0	59.9	1.3	15.1	100.5	31.7	380.8	2538.3
LD	QKMF-ISTOG	60,786	304	3,647	24,314	0.5	6.5	43.5	0.9	10.9	72.9	23.0	276.5	1843.1
LD	QKMF-KUJINË	44,357	222	2,661	17,743	0.4	4.8	31.8	0.7	8.0	53.2	16.8	201.7	1345.0
LD	QKMF-DECAN	26,786	134	1,607	10,714	0.2	2.9	19.2	0.4	4.8	32.1	10.2	121.8	812.2
LD	QKMF-JUNIK	3,571	18	214	1,426	0.0	0.4	2.6	0.1	0.6	4.3	1.4	16.2	106.3
LD	QKMF-GJAKOVË	89,643	445	5,379	35,857	0.8	9.6	64.2	1.3	16.1	107.6	34.0	407.7	2718.1
LD	QKMF-FERIZAJ	128,000	640	7,680	51,200	1.1	13.7	91.6	1.9	23.0	153.6	48.5	582.2	3881.2
LD	QKMF-KAÇANIK	36,071	180	2,164	14,428	0.3	3.9	25.8	0.5	6.5	43.3	13.7	164.1	1093.7
LD	QKMF-SHTITË	32,143	161	1,929	12,657	0.3	3.5	23.0	0.5	5.8	36.6	12.2	146.2	974.6
LD	QKMF-GJILAN	85,714	429	5,143	34,286	0.8	9.2	61.4	1.3	15.4	102.9	32.5	389.8	2599.0
LD	QKMF-VITI	41,071	205	2,464	16,428	0.4	4.4	29.4	0.8	7.4	49.3	15.6	186.8	1245.3
LD	QKMF-N.BËRD	2,571	13	154	1,028	0.0	0.3	1.8	0.0	0.5	3.1	1.0	11.7	78.0
LD	QKMF-KAMENICE	19,500	98	1,170	7,800	0.2	2.1	14.0	0.3	3.5	23.4	7.4	88.7	591.3
LD	QKMF-H. I ELEZIT	12,143	61	729	4,857	0.1	1.3	8.7	0.2	2.2	14.6	4.6	55.2	368.2
LD	QKMF-SHTËRPEC	10,286	51	617	4,114	0.1	1.1	7.4	0.2	1.9	12.3	3.9	46.8	311.9
LD	QKMF-PARTËSH	10,286	51	617	4,114	0.1	1.1	7.4	0.2	1.9	12.3	3.9	46.8	311.9
LD	QKMF-GRAGANIC	10,286	51	617	4,114	0.1	1.1	7.4	0.2	1.9	12.3	3.9	46.8	311.9

Moderna dhe Astra/Zeneka.

SC level	Facility	population	number of COVID doses (2 per person)			volume of vaccine (litres)			volume of diluent (litres)			volume of dry goods (litres)		
			0.25%	3%	20%	0.25%	3%	20%	0.25%	3%	20%	0.25%	3%	20%
PR	IKSHPK - Qendër	1,840,929	9,205	110,456	736,372	42.6	511.4	3409.4	0.0	0.0	0.0	585.5	7025.6	46837.4
LD	QKMF-PRISHTINE	257,143	1,286	15,429	102,857	6.0	71.4	476.2	0.0	0.0	0.0	81.8	981.3	6542.3
LD	QKMF-PODUJEVË	87,071	425	5,224	34,828	2.0	24.2	161.3	0.0	0.0	0.0	27.7	332.3	2215.3
LD	QKMF-DRENAS	73,643	368	4,419	29,457	1.7	20.5	136.4	0.0	0.0	0.0	23.4	281.0	1873.6
LD	QKMF-LIPJAN	61,429	307	3,886	24,572	1.4	17.1	113.8	0.0	0.0	0.0	19.5	234.4	1562.9
LD	QKMF-OBILID	23,571	118	1,414	9,428	0.5	6.5	43.7	0.0	0.0	0.0	7.5	90.0	599.7
LD	QKMF-F.KOSOVE	42,857	214	2,571	17,143	1.0	11.9	79.4	0.0	0.0	0.0	13.6	163.6	1090.4
LD	QKMF-PRIZREN	192,143	961	11,529	76,857	4.4	53.4	355.8	0.0	0.0	0.0	61.1	733.3	4885.6
LD	QKMF-MAMUSHË	5,357	27	321	2,143	0.1	1.5	9.9	0.0	0.0	0.0	1.7	20.4	136.3
LD	QKMF-MALISHEVË	86,429	432	5,186	34,572	2.0	24.0	160.1	0.0	0.0	0.0	27.5	329.8	2198.9
LD	QKMF-DRAGASH	20,714	104	1,243	8,286	0.5	5.8	38.4	0.0	0.0	0.0	6.6	79.1	527.0
LD	QKMF-THERANDË	63,857	319	3,831	25,543	1.5	17.7	118.3	0.0	0.0	0.0	20.3	243.7	1624.7
LD	QKMF-RAHOVEÇ	49,500	248	2,970	19,800	1.1	13.8	91.7	0.0	0.0	0.0	16.7	188.9	1259.4
LD	QKMF-MITROVICË	80,714	404	4,843	32,286	1.9	22.4	149.5	0.0	0.0	0.0	25.7	308.0	2053.5
LD	QKMF-VUSHITRI	77,357	387	4,641	30,943	1.8	21.5	143.3	0.0	0.0	0.0	24.6	295.2	1968.1
LD	QKMF-SKENDERAJ	53,071	265	3,184	21,228	1.2	14.7	98.3	0.0	0.0	0.0	16.9	202.5	1350.2
LD	QKMF-PEJË	83,714	419	5,023	33,486	1.9	23.3	155.0	0.0	0.0	0.0	26.8	319.5	2129.9
LD	QKMF-ISTOG	60,786	304	3,647	24,314	1.4	16.9	112.6	0.0	0.0	0.0	19.3	232.0	1546.5
LD	QKMF-KLINE	44,357	222	2,681	17,743	1.0	12.3	82.1	0.0	0.0	0.0	14.1	169.3	1128.5
LD	QKMF-DEÇAN	26,788	134	1,607	10,714	0.6	7.4	49.6	0.0	0.0	0.0	8.5	102.2	681.5
LD	QKMF-JUNIK	3,571	18	214	1,428	0.1	1.0	6.6	0.0	0.0	0.0	1.1	13.6	90.9
LD	QKMF-GJAKOVË	89,643	448	5,379	35,857	2.1	24.9	166.0	0.0	0.0	0.0	28.5	342.1	2280.7
LD	QKMF-FERIZAJ	128,000	640	7,680	51,200	3.0	35.6	237.1	0.0	0.0	0.0	40.7	488.5	3256.6
LD	QKMF-KAÇANIK	36,071	180	2,184	14,428	0.8	10.0	66.8	0.0	0.0	0.0	11.5	137.7	917.8
LD	QKMF-SHTIME	32,143	161	1,929	12,857	0.7	8.9	59.5	0.0	0.0	0.0	10.2	122.7	817.8
LD	QKMF-GJILAN	85,714	429	5,143	34,286	2.0	23.8	158.7	0.0	0.0	0.0	27.3	327.1	2180.8
LD	QKMF-VITI	41,071	205	2,464	16,428	1.0	11.4	76.1	0.0	0.0	0.0	13.1	156.7	1044.9
LD	QKMF-N.BËRD	2,571	13	154	1,028	0.1	0.7	4.8	0.0	0.0	0.0	0.8	9.8	65.4
LD	QKMF-KAMENICË	19,500	98	1,170	7,800	0.5	5.4	36.1	0.0	0.0	0.0	6.2	74.4	496.1
LD	QKMF-H. I ELEZIT	12,143	61	729	4,857	0.3	3.4	22.5	0.0	0.0	0.0	3.9	46.3	308.9
LD	QKMF-SHTERPC	10,286	51	617	4,114	0.2	2.9	19.0	0.0	0.0	0.0	3.3	39.3	261.7
LD	QKMF-PARTESH	10,286	51	617	4,114	0.2	2.9	19.0	0.0	0.0	0.0	3.3	39.3	261.7
LD	QKMF-GRAGANIC	10,286	51	617	4,114	0.2	2.9	19.0	0.0	0.0	0.0	3.3	39.3	261.7

Strategjitë e zinxhirit të ftohtë në bazë të llojeve të ndryshme të vaksinave të mundshme

Dispozitat për ruajtjen, vendosjen dhe monitorimin e secilës vaksinë COVID-19 është miratuar si strategji e zinxhirit të ftohtë në Kosovë, përfshirë vaksinat Pfizer/BioNTech pasi Kosova ka edhe depot e QKUK-së si dhe kapacitete për prodhimin e akullit të thatë.

Kosova ka kapacitete për ta prodhuar dhe ruajtur akullin e thatë në sasi të mjaftueshme për t'i rimbushur kutitë transportuese të Pfizer. Ka kompani private të identifikuar në vend për prodhimin e akullit të thatë. Kapacitetet prodhuese brenda javës janë deri në 4 tonelata dhe mund ta rrisin prodhimin sipas nevojës.

Transporti i vaksinave COVID-19 (ULT ose të tjerave) dhe mallrave të thata brenda Kosovës për vaksinimin e 3% të popullatës nuk paraqet ndonjë sfidë të madhe pasi vëllimet janë të vogla dhe automjetet janë në dispozicion si në depon qendrore të vaksinave ashtu edhe në secilën komunë. Sfidat janë më të orientuara kah ndërtimi i kapaciteteve për trajtimin e akullit të thatë për shembull dhe për mikro planifikimin, menaxhimin operativ dhe atë të dhënave si dhe monitorimin/ mbikëqyrjen.

Në këtë kontekst, kërkesat kyçe për vendosjen efektive dhe efikase të cilës do ose të gjitha llojeve të vaksinave COVID-19 dhe mallrave të thata në Kosovë janë parashikuar si më poshtë:

- Mikro planifikimi i logjistikës, përfshirë burimet njerëzore, financiare dhe materiale në dispozicion.
- Mikro planifikimi i kërkesës, caktimi i seancave, planifikimi i grupeve të synuara, gjurmimi dhe raportimi i imunizimit.
- Planifikimi i lokacionit, kërkesat organizative dhe ato materiale, për ruajtjen e vaksinave, ndarjen e mbeturinave, largësinë e popullatës dhe pastrimin e vendit.
- Trajnim rigoroz i personelit

- Menaxhimi i saktë dhe i shpejtë i të dhënave për rezerva të vaksinave dhe mallrave të thata, lëvizjet e stoqeve, sigurimi i cilësisë së magazinimit të vaksinave gjatë ruajtjes dhe transportit.

- Planifikimi i menaxhimit të mbetjeve dhe asgjësimi i sigurt i tyre
- Mbikëqyrja dhe përcjellja e koordinuar e menaxhimit.

Përderisa ekzistojnë dallime të rëndësishme procedurale në ruajtjen dhe praktikën e administrimit të vaksinave, veçanërisht mes vaksinave Pfizer/ BioNTech, Moderna dhe AstraZeneca, kërkesat thelbësore për vendosje janë të zakonshme.

Kosova do t'i ndjekë udhëzimet dhe hapat proceduralë të përcaktuara në dokumentin e kompletuar dhe të rishikuar të VIRAT/ VRAM, dhe burimet e dobishme të siguruar përmes RO për t'i mbështetur aktivitetet e saja të planifikimit dhe përgatitjes. Një vlerësim paraprak i kostove të disa përbërësve të programit është vlerësuar nga vlerësimet globale të siguruar nga UNICEF-i dhe OBSH-ja. Vlerësimet për kostot specifike të artikujve të linjës janë përmbledhur më poshtë.

Kërkesat për ta mbështetur vendosjen shtrihen përtej planifikimit, ndërtimit të kapaciteteve, menaxhimit dhe masave për sigurimin e cilësisë të përmendura më lart. Kërkesat shtrihen në forcimin dhe zgjerimin e zinxhirit të furnizimit me jonizim për të siguruar sisteme të fuqishëm dhe funksional i aftë për ta mbështetur vendosjen.

Marrëveshjet kontraktuese për ruajtjen dhe transportin e vaksinave nuk kërkohen pasi ekziston kapaciteti adekuat i brendshëm për ruajtje dhe transport.

Menaxhimi i të dhënave të programit rutinë të imunizimit është i vendosur siç duhet, por ka nevojë për modernizim për të lehtësuar raportimin në kohë reale të sasisë së stoqeve, lëvizjeve të stoqeve, cilësisë së ruajtjes së vaksinave dhe kapaciteteve në dispozicion për ruajtjen e vaksinave. Aktualisht raportimi bëhet në letër dhe dorëzohet nga QKMF-të çdo muaj në nivelin qendror (Instituti Kombëtar të Shëndetit Publik). Monitorimi i temperaturës raportohet dy herë në ditë me dorë (me formular të letrës).

Buxheti i mësipërm përfshinë parashikime për ta fuqizuar monitorimin e temperaturës së PZF dhe për ta lehtësuar kalimin në monitorimin e temperaturës në kohë reale në objektet qendrore dhe në ato të QKMF –së me shtrirjen eventuale edhe në objektet e QMF-ve/ AFM-ve. Marrëveshjet aktuale afatgjata (LTA) të bëra me UNICEF-in/SD-në nuk përfshijnë dispozita për ndërtime mbi themele ekzistuese të pajisjeve për monitorimin e temperaturës tashmë të instaluar në Kosovë për të siguruar platformë të vetme në tërë vendin.

Edhe pse zinxhiri ekzistues i ftohjes është i aftë t'i trajtojë dozat e vaksinave COVID-19 që planifikohen për t'u marrë në tre fazat e vaksinimit, nevojitet zëvendësimi i pajisjeve. Pajisjet e zinxhirit të ftohtë në Kosovë janë të vjetra 20 vjet dhe nuk janë në përputhje me rekomandimet e OBSH-së për pajisjet për ruajtjen e vaksinave. Madje, 7 ngrirës të rinj ULT që janë blerë nuk janë të dedikuara për vakcina dhe do të kthehen për qëllime tjera posa të jenë në dispozicion ngrirësit e rinj për vakcina. Zëvendësimi i zinxhirit të ftohtë nuk do të bëhet me programet ekzistuese të imunizimit, përfshirë vaksinimin me COVID-19, pasi që zëvendësimi do të bëhet në mënyrë graduale.

Zëvendësimi i PZF kërkohet në të gjitha nivelet e zinxhirit të ftohtë ku ruhen vaksinat. Për zëvendësimin rekomandohet qasje fazore, ashtu që të sigurohet hapësirë e mjaftueshme për t'i trajtuar dhe ruajtur të gjitha vaksinat, përfshirë vaksinat e COVID-19. E tërë pajisja e prokuruar do të jetë e parakualifikuar nga OBSH/ PQS dhe duhet të ketë pajisje për monitorimin e temperaturës. Procesi i prokurimit do të fillojë në shkurt 2021. Procesi i prokurimit pritet të zgjasë deri në 3 muaj që të përfundojë, ndërsa i gjithë procesi i instalimit dhe zbatimit të PZF zgjatë deri 6 muaj.

Zëvendësimi i PZF parashikohet të bëhet në dy faza. Faza e parë është prokurimi i pajisjeve që do të zgjasë 3 muaj. Faza e dytë është zbatimi/ instalimi, i cili do të zgjasë deri në 3 muaj.

Zëvendësimi i pajisjeve të zinxhirit të ftohtë do të përfshijë:


1. Prokurimi i 16 ngrirësve me temperaturë ultra të ulët secili me > 360 kapacitet neto.
2. Prokurimi dhe instalimi i sistemit wireless për monitorimin e temperaturës në kohë reale RTMD (Pajisjet Monitoruese në kohë Reale) në depon qendrore ekzistuese.
3. Identifikimi i lokacionit nga Ministria e Shëndetësisë (MSH) për ndërtimin e depon së re qendrore për vakcina.
4. Ftesa për tenderë dhe kontrata për shërbimet arkitektonike, ndërtimore dhe sigurimit të cilësisë për depon e re qendrore për vakcina përfshirë shërbimet komunale (HVAC, shpërndarja e rrymës elektrike, zona për paketim/ pastrim, mbrojtja nga zjarri etj.)
5. Prokurimi dhe instalimi 3-40 m³ hapësirë për ftohje, 1-40 m³ hapësirë për ngrirje, servo stabilizuesit për secilën hapësirë për ftohje/ ngrirje, set gjenerues >75kVA dhe kontratë për mbështetje të shërbimeve për mirëmbajtje ose ESS.
6. Shërbime kontraktuese për vlerësimin e nevojave për masa tjera (ngritja e kapaciteteve, komunikimet,
7. Menaxhimi i mbeturinave)
8. Prokurimi i pajisjeve ndihmëse për trajtimin dhe grumbullimin e artikujve
9. Prokurimi i automjeteve frigoriferë për mbledhjen dhe shpërndarjen e vaksinave në objektet e Qendrave Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF).
10. Prokurimi dhe instalimi i FPZF në objektet e QKMF-ve dhe Qendrave të Mjekësisë Familjare (QMF)/ Ambulantave të Mjekësisë Familjare (AMF).
11. Zgjerimi i sistemit RTMD në depon qendrore për ta përfshirë monitorimin e temperaturës në frigoriferët në QKMF, QMF dhe AMF.
12. Prokurimi i PZF për Qendrën Kombëtare të Kosovës për Transfuzionin e Gjakut (QKKTGj) dhe depon qendrore (DQ) të MSH-së.

Buxheti i vlerësuar i përgjithshëm për zbatimin e programit të imunizimit për fuqizimin e zinxhirit të ftohtë është 2,291,739 dollarë.

Menaxhimi i mbetjeve të imunizimit dhe biorreziqeve

Sa i përket menaxhimit të mbeturinave nga vaksinimi COVID-19 kërkon vëmendje të veçantë. Institucioni përgjegjës për menaxhimin e mbetjeve është në Ministrinë e Ekonomisë dhe Mjedisit. Gjatë procesit të vaksinimit, mbetjet e produktit mjekësor dhe materialit të përdorur do të vendosen në kutitë e sigurisë nga ekipet e vaksinimit. Këto kuti të sigurisë kthehen më pas në objektin për grumbullimin e vaksinave. Kutitë e sigurisë dërgohen për asgjësim bazuar në dispozitat e Ligjit për Produktet dhe Pajisjet Mjekësore Nr. 04/L-190 dhe Udhëzimit Administrativ për trajtimin e mbeturinave të produkteve mjekësore nr. 10/2015. Sipas këtyre dokumenteve ligjore, mbetjet nga produktet mjekësore së pari klasifikohen, dhe më pas depozitohen sipas metodës më të përshtatshme për secilën kategori. Forma e depozitimit të këtyre mbetjeve dhe licenca e institucioneve dhe kompanive për asgjësimin e mbetjeve mjekësore miratohen nga Ministria e Mjedisit.


National Store Dry Goods Max Volumes



Vëllimi i produkteve të thata të vaksinave COVID-19 është i madh dhe madje edhe për popullatën e synuar prej 20%, tejkalon vëllimet e produkteve të thata për programin rutinë të imunizimit dhe SIA-të siç tregohet në figurën më poshtë e modeluar për 20% të popullsisë që përdorin vaksinat e Pfizer/BioNTech.

Vëllimet e mbeturinave përbëjnë pjesën më të madhe të materialeve të thata të paketuara në kutitë e sigurisë plus flakonët dhe paketimet e vaksinave. Përqindje e këtij vëllimi të mbeturinave, zakonisht 10-15%, janë mbetje infektive, që kërkojnë vëmendje të veçantë për riciklimin ose asgjësimin përfundimtar të tyre. Bilanci i mbetjeve jo-infektive mund të hidhet në deponitë komunale nëse menaxhohet siç duhet. Mbeturinat e imunizimit rutinë krijohen në objektet e kujdesit shëndetësor

Volume of immunization waste per year for each QKMF



parësor dhe vëllimet janë të vogla. Kur transportohen nëpër komuna dhe kombinohen me mbeturinat e vaksinave COVID-19, vëllimi i përgjithshëm vlerësohet të jetë 84 m³ me COVID-19 për synimin prej 20% të popullsisë. Asnjëra komunë nuk ka nevojë të trajtojë më shumë se 11.3 m³ mbeturina në vit siç tregohet në figurën më poshtë. 6.35 m³ e kësaj do të ishin mbetje nga vakcina COVID-19.

Trajtimi i sigurt i mbetjeve infektive dhe asgjësimi i tyre është i një rëndësie kulmore. Kosova ka planifikuar dhe buxhetuar për hedhje të mbeturinave dhe për ndërtim të kapaciteteve kombëtare për ndarjen, trajtimin, transportimin dhe asgjësimin ose riciklimin e duhur të mbeturinave. Menaxhimi i mbeturinave do të jetë element i integruar i procesit të mikro planifikimit të diskutuar më lart.

Në tërë vëllimin e përafërt prej 10 m³ të mbetjeve infektive që krijohet çdo vit i shtohet edhe 30 m³ në vit si popullatë e synuar në synimin kombëtar të Kosovës. Kosova do t'i eksplorojë mundësitë për hedhjen e mbeturinave infektive në repartet industriale për prodhimin e çimentos, për t'i shndërruar mbeturinat në energji etj.

5. Trajnimi dhe menaxhimi i burimeve njerëzore

Bazuar në Planin për burimet njerëzore në Strategjinë e Sektorit Shëndetësor 2020 - 2021, aktualisht në Kosovë ka 2,703 mjekë dhe 7,700 infermierë në institucionet shëndetësore publike të të tre niveleve të kujdesit shëndetësor. Numri i përgjithshëm i ekipeve të imunizimit të vendosura në secilën prej 38 komunave të Kosovës është 630. Numri i pikave të ofrimit të shërbimeve për programin e rregullt të imunizimit është 174.

Bazuar në kapacitetin ekzistues të burimeve njerëzore, Komiteti për vaksinimin kundër COVID-19 vlerësoi se ekipet ekzistuese të vaksinimit të angazhuara në Programin Kombëtar të Vaksinimit janë të mjaftueshme për fazën e parë të vaksinimit kundër COVID-19. Sidoqoftë, nëse do të jenë në dispozicion sasi të vaksinave më të mëdha se sa ishte planifikuar, mund të zbatohet një rritje e kapaciteteve të burimeve njerëzore. Kjo mund të bëhet në dy skenarë: duke rritur orët e punës së personelit aktual, ose duke punësuar personel shtesë. Nëse Komiteti vlerëson se është e nevojshme një rritje e numrit të personelit, ky personel shtesë duhet të trajnohet në mënyrë të ngjashme si personeli ekzistues.

Metodologjia e detajuar e trajnimit me burimet e kërkuara njerëzore është planifikuar bazuar në modulet e trajnimit të zhvilluara nga OBSH dhe UNICEF për punonjësit shëndetësorë. Takimi koordinues i trajnerëve u zhvillua më 22 Janar. Seanca e parë e trajnimit ka filluar më 4 shkurt ndërsa të gjitha trajnimet për fazën e parë, online dhe fizikisht, janë planifikuar të përfundojnë brenda një jave.

Lidhur me zinxhirin e ftohtë dhe personelin e logjistikës, nuk ka nevojë për rekrutim shtesë. Në nivelin qendror (IKShP), pajisjet e zinxhirit të ftohtë menaxhohen nga personi përgjegjës brenda Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik. Në nivelin lokal, zinxhiri i ftohtë menaxhohet nga ekipet e vaksinimit të Programit të Rregullt të Imunizimit.

Mbikëqyrja

Praktikat aktuale të Programit të Zgjeruar të Imunizimit (PZI) zbatojnë mbikëqyrje të organizuar nga niveli qendror dhe rajonal. Mbikëqyrja bëhet në mënyrë periodike bazuar në listën standarde të kontrollit: baza e të dhënave, zinxhiri i ftohtë, administrimi i vaksinave, asgjësimi i shiringave dhe flakonëve, ruajtja e flakonëve shumëpërdorimshme pas përdorimit të parë. Sa i përket planit të vaksinimit kundër COVID-19, bazuar në strategjinë e shpërndarjes së vaksinave, secili ekip i caktuar për administrimin e vaksinave do të mbikëqyret nga ekipi i kombinuar i IKSHPK-së qendrore dhe rajonale, bazuar në udhëzimet standarde të OBSH-së mbi mjetet e mbikëqyrjes. Këto ekipe do të shoqërohen nga MSH, OBSH dhe ekipet monitoruese të UNICEF.

Audienca e synuar

Ekipet qendrore dhe lokale të imunizimit, mjekët, infermierët, menaxherët lokal të shëndetit, teknikët e zinxhirit të ftohtë, media dhe folësit në media.

Metodologjia e trajnimit

Një mjek me dy teknikë të cilët tashmë janë duke punuar në programin e imunizimit janë përcaktuar si ekip për të kryer dhe menaxhuar vaksinimin për grupet prioritare të ndara në tri faza. Ekspertët e imunizimit nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike dhe OBSH tashmë janë në proces të

adaptimit të paketës së trajnimit, dhe do të ofrojnë trajnimin për ekipet e përbëra bazuar në tri faza. Shikoni tabelën numër 10, e cila përmbledh metodologjinë e trajnimit duke përfshirë mbulimin e grupeve prioritare dhe burimet e nevojshme njerëzore:

Tabela 10. Metodologjia e trajnimit e organizuar në tri faza të ndryshme

Fazat	Grupet prioritare	Burimet njerëzore të nevojshme për trajnim	Modaliteti i trajnimit	Mbulimi	Kohëzgjatja për dhënien e vaksinave
Sesioni i trajnimit 1	Punëtorët esenciale shëndetësorë dhe të moshuarit që jetojnë në shtëpi banimi	26 ekipe të përbëra nga një mjek dhe dy infermierë. Gjithsej 78 ofrues të shërbimeve	Trajnim online dhe fizikisht për ofruesit e shërbimeve në nivelin qendror	54,000 ose 3% e popullsisë	7 ditë
Sesioni i trajnimit 2	Punëtorë të tjerë shëndetësorë dhe socialë, njerëz mbi 65 vjeç, njerëz me sëmundje kronike.	42 ekipe të përbëra nga një mjek dhe dy infermierë. Gjithsej 126 ofrues të shërbimeve	Trajnim online dhe fizikisht për ofruesit e shërbimeve në nivelin e distrikteve (7 distrikte)	306,000 ose 17% e popullsisë	1-2 javë
Sesioni i trajnimit 3	Punëtorët kryesorë shëndetësorë dhe të moshuarit që jetojnë në shtëpi banimi	Burimet ekzistuese njerëzore në shërbimet e rregullta të imunizimit nga 38 komuna. Në total 212 ekipe ose 630 ofrues të shërbimeve	Trajnim online dhe fizikisht për ofruesit e shërbimeve në nivelin komunal (38 komuna)	900,000 ose 50 % e popullsisë	Vazhdon

Materialet e trajnimit

Paketa e trajnimit për vaksinimin kundër COVID-19 për punëtorët shëndetësorë është krijuar për punëtorët shëndetësorë të vijës së parë, që është zhvilluar nga OBSH në bashkëpunim me UNICEF. Paketa e trajnimit përbëhet nga 6 module të shpjeguara në tabelën në vijim:

Tabela 11. Modulet e trajnimit

Modulet e trajnimit	Temat e trajnimit	Numri i të trajnuarve	Kohëzgjatja e trajnimit	Trajnerët

Hyrje në trajnimin për vaksinimin kundër COVID-19	Informacion kyç për vaksinimin kundër COVID-19 për punonjësit shëndetësorë / vaksinuesit.	900	30 min	IKSHPK, specialisti i imunizimit, OBSH
Moduli 2: Ruajtja, trajtimi, dhënia dhe menaxhimi i mbetjeve të vaksinave kundër COVID-19:	Implikimet programore të vaksinave kundër COVID-19; Menaxhimi i ruajtjes, transportit dhe shpërndarjes së vaksinave COVID-19; Menaxhimi i zinxhirit të ftohtë dhe mbetjeve	900	2 orë	IKSHPK, specialisti i imunizimit, OBSH
Moduli 3: Organizimi i sesioneve të vaksinimit kundër COVID-19:	Masat IPC gjatë seancave të vaksinimit; Përshkruani se si përgatiteni për seancat e vaksinimit sipas protokolleve IPC; Përshkruani procesin e administrimit të sigurt të vaksinave kundër COVID-19 dhe asgjësimin e mbetjeve.	1300	1 orë	IKSHPK, specialisti i imunizimit, OBSH
Moduli 4: Monitorimi i EPPV për vaksinimin kundër COVID-19:	Identifikoni një ngjarje negative pas imunizimit (EPPV); Identifikoni dhe përgjigjuni tek EPPV.	24	2 orë	IKSHPK, specialisti i imunizimit, OBSH
Moduli 5: Regjistrimi dhe monitorimi i vaksinimit kundër COVID-19:	Rëndësia e regjistrimit dhe raportimit të duhur; Njihni format e regjistrimit dhe regjistrimit; regjistroni saktë të dhënat e vaksinimit dhe regjistroni vaksinat në format e raportimit	1000	1 orë	IKSHPK, specialisti i imunizimit, UNICEF, OBSH
Moduli 6: Komunikimi me komunitetin rreth vaksinimit kundër COVID-19:	Rolet dhe përgjegjësitë për vaksinimin kundër COVID-19; Demonstroni komunikime efektive dhe të individualizuara në lidhje me vaksinimin kundër COVID-19; Strategjitë e komunikimit për tre skenarë të mundshëm me anëtarët e komunitetit; Roli i një vaksinuesi në komunikimin e krizës për efektet e padëshirueshme pasvaksinale(EPPV).	900	1 orë	IKSHPK, specialisti i imunizimit, UNICEF, OBSH

Përveç modulit të zhvilluar nga OBSH dhe UNICEF, për fazën e parë të trajnimit, rekomandimet e përkohshme të SAGE për përdorimin e vaksinës Pfizer-BioNTech COVID-19 (BNT162b2)²³, do të përdoren si material trajnimi. Materialet e trajnimit janë dërguar tashmë për përkthim në gjuhët shqipe dhe serbe dhe do të jenë gati më datën 25 kur do të fillojnë trajnimet. Ekipi i trajnerëve përbëhet nga një specialist i imunizimit dhe dy trajnerë nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik (IKSHPK) dhe OBSH.

²³Rekomandime të përkohshme për përdorimin e vaksinës Pfizer–BioNTech kundër COVID-19, BNT162b2, nën Listën e Përdorimit Emergjent: https://www.who.int/publications/i/item/WHO-2019-nCoV-vaccines-SAGE_recommendation-BNT162b2-2021.1

6. Pranimi dhe marrja (kërkesa) e vaksinave

Disponueshmëria e të dhënave sociale dhe të sjelljes (socio-bihejviorale) për pranimin e vaksinave

Së fundmi, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike me mbështetjen e OBSH-së ka realizuar Anketën e njohurive të sjelljes mbi COVID-19 me popullatën në Kosovë dhe është në proces të publikimit të të dhënave. Deri më tani, informacioni i disponueshëm për publikun mbi pranimin e vaksinave nga një studim i realizuar me popullatën në Kosovës tregon se rreth 56% e popullsisë raportojnë se nuk do të merrnin vaksinën kundër COVID-19 (të sigurt që jo ose me gjasë jo)²⁴. Sondazhi i U-Report që është kryer me të rinjtë sa i përket vaksinës dhe hezitimit të perceptimit tregon se rreth 25% e të rinjve nuk do të merrnin vaksinën kundër COVID-19 ndërsa 35% nuk janë të vendosur për këtë gjë (nuk e dijnë)²⁵.

Informacioni mbi faktorët e motivimit dhe barrierat për pranimin e vaksinimit kundër COVID-19 në mesin e popullatës në Kosovë nuk janë në dispozicion aktualisht, me përjashtim të të dhënave të kufizuara në lidhje me mendimet e të rinjve. Në pyetjen pasuese e cila është bërë tek ata persona që u përgjigjën me "Jo" për marrjen e vaksinës në sondazhin e U-Report, 33% e të rinjve raportuan si arsye që nuk kishin informacion të mjaftueshëm në lidhje me vaksinën, 29% mendojnë se vakcina e re nuk do të jetë e sigurt për përdorim dhe 22% të tjerë konsiderojnë se COVID-19 nuk është një sëmundje serioze për të konsideruar marrjen e vaksinës.

Studimet sugjerojnë se ekziston një korrelacion i fortë midis besimeve në konspiracione dhe pranueshmërisë së ulët të vaksinimit. Rreth 72% e popullsisë në Kosovë besojnë shumë ose deri diku në teoritë më të zakonshme të konspiracionit në lidhje me pandeminë COVID-19. Kjo përqindje është e ngjashme me atë të vendeve në Ballkanin Perëndimor megjithatë dukshëm më e lartë krahasuar me vendet e Evropës Perëndimore, ku rreth një e treta e popullsisë besojnë në teoritë e konspiracionit. Është gjithashtu interesante të përmendet se midis grupmoshave të ndryshme, ata të moshës 60+ vjeç kishin më pak gjasa të besonin në teoritë e konspiracionit krahasuar me grupmoshat tjera. Nuk ka pasur asnjë dallim midis popullatës nga rajone të ndryshme gjeografike, meshkuj/femra dhe zona urbane/rurale në Kosovë. Sidoqoftë, popullsia pakicë në Kosovë kishte më shumë gjasa të besonte në konspiracione rreth COVID-19 krahasuar me shumicën shqiptare të popullsisë.

Qëllimi

Qëllimi i gjenerimit të kërkesës dhe ndërhyrjeve për marrjen e vaksinave është rritja e besimit dhe pranimi i vaksinës kundër COVID-19 midis grupeve të popullatës së synuar për imunizim dhe gjenerimi i kërkesës për vaksinimin kundër COVID-19.

Për të arritur këtë qëllim, do të përdoren qasjet e mëposhtme strategjike: menaxhimi i keqinformimit, komunikimi i rrezikut dhe angazhimi i komunitetit, ngritja e kapaciteteve të punëtorëve shëndetësor në vijën e parë dhe komunikimi i krizave, gjenerimi i të dhënave dhe shpërndarja e informacionit.

²⁴Sondazhi BIEPAG-IPSOS: Virusi i dyshimtë: Konspiracionet dhe COVID-19 në Ballkan, tetor 2020

²⁵Sondazhi U-Report për Kosovën: Perceptimi dhe Besimi ndaj Vaksinës (Rezultatet Preliminare), dhjetor 2020

Qasjet Strategjike

Të dhënat e kufizuara në dispozicion sa i përket hezitimit të marrjes së vaksinave tregojnë që popullata e përgjithshme në Kosovë është e ndarë për gjysmë lidhur me çështjen e pranimi të vaksinës. Nuk ka shumë informacione sa i përket arsyeve që qëndrojnë prapa pengesave dhe nxitësve të pranimi të vaksinave. Informata të gabuara dhe konspiracioni rreth vaksinave janë të përhapura në mesin e popullatës në Kosovë, të cilat kanë dëshmuar se kanë implikime në shëndetin publik, besimin në institucione dhe zbatimin e politikave të bazuara në dëshmi.

Futja e vaksinave të reja në përdorim ka nevojë për komunikim efektiv duke kombinuar qasje të ndryshme strategjike për zbatimin e suksesshëm të programit të vaksinimit kundër COVID-19²⁶²⁷. Përfshirja e komunitetit, vetëdijesimi publik, besimi në sigurinë e vaksinave, menaxhimi i keqinformimit rreth vaksinave, si dhe besimi i rikthyer në institucione janë pika kritike për pranimin e vaksinave.

Pesë udhëzimet strategjike të mëposhtme sugjerohen për forcimin e kërkesës për vakcina: a) **Menaxhimi i keqinformimit**, b) **Angazhimi i komunitetit**, c) **Ngritja e kapaciteteve të punëtorëve shëndetësorë**, d) **Komunikimi i krizave** e) **Gjenerimi i të dhënave dhe shpërndarja e informacionit**

Menaxhimi i keqinformimit

Gjatë pandemisë COVID-19, keqinformimi ishte përhapur në Kosovë duke çuar në konfuzion, mosbesim në ashpërsinë e sëmundjes dhe mos respektim të masave parandaluese. Mungesa e strategjive të koordinuara dhe të informuara të komunikimit, si dhe pasiguria pas pandemisë COVID-19 ofruan një mundësi dhe një boshllëk i cili u mbush me dezinformata për pandeminë dhe vaksinën kundër COVID-19.

Objektivi:

Të adresohet hezitimi ndaj vaksinës duke trajtuar dhe neutralizuar lajmet e pavërteta dhe mitet rreth vaksinës COVID-19 përmes dëgjimit social, të kuptuarit dhe përfshirjes digjitale dhe të sigurohet besimi i publikut në sigurinë dhe efikasitetin e vaksinës kundër COVID-19.

Intervenimet:

1. Dëgjimi social dhe përfshirja digjitale

- a) *Të krijohet ekipi kombëtar për të udhëhequr iniciativën 'Dëgjimi social' i përbërë nga përfaqësues përkatës nga Ministria e Shëndetësisë, IKSHPK, OJQ-të, UNICEF-i etj.*
- b) *Të trajnohen anëtarët e ekipit kombëtar mbi mjetet dhe metodologjitë për monitorimin e mediave dhe të dëgjimit social si burime të të dhënave rreth perceptimeve, shqetësimeve dhe mirëkuptimit rreth vaksinës kundër COVID-19.*
- c) *Të gjenerohen raporte periodike (javore) për dëgjimin social, monitorimin e mediave dhe lidhur me thashethemet, për të dhënë informata sa i përket njoftimeve dhe ndërhyrjeve të gjenerimit të kërkesës.*

²⁶Konsideratat e sjelljes për pranimin dhe marrjen e vaksinave kundër COVID-19: Grupi këshillues teknik i OBSH-së mbi njohuritë e sjelljes dhe shkencat për shëndetin, raporti i takimit, 15 tetor 2020 <https://apps.who.int/iris/handle/10665/337335>

²⁷ Adresimi i hezitimit për vaksinim dhe fuqizimi i kërkesës për imunizim - Shënim nga strategjia, UNICEF ECARO

- d) Të zhvillohen, realizohen fushata të përshtatura të bazuara në dëshmi, të mediave sociale për të fuqizuar besimin në vaksinat kundër COVID-19.

Kosova është pjesë e një iniciative rajonale për "Dëgjimin social" të mbështetur nga UNICEF në bashkëpunim me Projektin për Besimin ndaj Vaksinave (VCP) në Shkollën e Londrës për higjienë dhe mjekësi tropikale. Projekti i cili do të drejtohet nga një ekip kombëtar do të sigurojë monitorimin e vazhdueshëm të mediave sociale të bisedave rreth imunizimit në Kosovë. Analiza e marrë përmes dëgjimit social do të informojë fushatat e synuara që adresojnë keqinformimin mbi vaksinën kundër COVID-19.

Angazhimi i Komunitetit

Angazhimi i komunitetit është thelbësor për pranimin e vaksinave. Kontakti me komunitetin, veçanërisht me komunitetin më të cenueshëm dhe të marginalizuar kërkon përdorimin e kanaleve të besueshme të komunikimit. Të mobilizohen dhe angazhohen partnerë kryesorë dhe komuniteti, siç janë OJQ-të lokale, udhëheqës të besuar të komunitetit, për të promovuar imunizimin kundër COVID-19.

Objektivi:

Të informohet, fuqizohet dhe angazhohet komuniteti për të forcuar besimin ndaj vaksinave dhe zvogëluar hezitimin ndaj vaksinave midis popullatave të synuara, si dhe grupeve më të marginalizuara dhe cenueshme të popullsisë.

Intervenimi:

1. 1. Të angazhohen ndikues të ndryshëm të komunitetit (fetarë, pakica etnike, ekspertë etj.) për të promovuar vaksinimin.
 - a) Të identifikohen ndikuesit kryesorë të komunitetit për audiencë të ndryshme (fetare, grupe të pakicave, ekspertë etj.)
 - b) Të organizohen takime me ndikuesit e komunitetit për të informuar mbi programin e vaksinimit kundër COVID-19
 - c) Të identifikohen ndikuesit në popullatën e synuar dhe të organizohen ngjarje për bashkëndarje të informacionit në media në të cilat ndikuesit do të ndajnë përvojën e tyre të vaksinimit.
2. Të promovohet vaksinimi midis popullatave të synuara përmes programit të vizitave në shtëpi (VSh)
 - a) Të trajnohen infermierët e VSh për vaksinën kundër COVID-19 dhe aftësitë e komunikimit.
 - b) Infermierët e vizitave në shtëpi do të promovojnë imunizimin tek popullatat e synuara gjatë vizitave të rregullta në shtëpi.

Programi i vizitave në shtëpi në Kosovë është ofrim shërbimi me familjen në qendër kushtuar nënave dhe fëmijëve nën moshën 3 vjeç, i cili drejtohet nga MSH-ja dhe funksionon në 27 komuna. Infermierët e VSh janë ofrues shumë të besuar të shërbimeve shëndetësore në komunitet dhe kanë përvojë në trajtimin e grupeve më të marginalizuara të popullsisë. Infermierët e shërbimit VSh do të promovojnë imunizimin dhe sigurojnë komunikimin e rrezeve për popullatat e synuara.

Ngritja e kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve (punëtorëve shëndetësorë)

Punëtorët shëndetësorë janë kanale mirë të besueshme të informimit. Si marrësit e parë të vaksinave dhe lajmëtarë në komunitet, profesionistët shëndetësorë luajnë një rol vendimtar në promovimin e marrjes së vaksinave midis pacientëve ose komuniteteve të tyre, duke adresuar shqetësimet dhe hezitimet.

Objektivi: Të përmirësohen njohuritë dhe të forcohen aftësitë ndërpersonale të komunikimit të punëtorëve shëndetësorë për të pranuar, besuar dhe promovuar vaksinimin.

1. Të rritet kapaciteti i punëtorëve shëndetësorë në aftësitë e komunikimit dhe angazhimin e komunitetit
 - a. Të zhvillohet modul trajnimi për Aftësitë e Komunikimit për punëtorët shëndetësor
 - b. Të realizohet trajnimi i punëtorëve shëndetësorë mbi njohuritë, aftësitë e komunikimit dhe komunikimin e rrezikut
 - c. Të përgatiten materiale komunikimi dhe informimi për të mbështetur komunikimin e punëtorëve shëndetësorë me marrësit e vaksinave.

Punëtorët shëndetësorë në Kosovë do të trajnohen sa i përket komunikimit rreth COVID -19 si një komponent brenda trajnimeve të përgjithshme për programin e vaksinimit kundër COVID-19. Trajnimi do të përqendrohet në forcimin e kompetencave ndërpersonale të komunikimit të ofruesve të shërbimeve shëndetësore dhe si të komunikojnë gjatë një VRE (ngjarje lidhur me vaksinat) ose kur lindin pyetje në lidhje me sigurinë e vaksinave. Materialet informuese do të përgatiten për të mbështetur komunikimin e rrezikut për punëtorët shëndetësorë me marrësit e vaksinave.

Komunikimi i krizës

Zhvillimi i vaksinës kundër COVID -19 përcillet me thashetheme në lidhje me procesin e zhvillimit, sigurinë dhe efikasitetin e vaksinës. Çdo mangësi e mundshme e programit të vaksinimit do të zmadhohet përmes mediave sociale dhe interesit masiv publik për vaksinimin. Prandaj, çdo ngjarje në lidhje me futjen e vaksinës në përdorim, efektet anësore serioze apo edhe imunizim AEF mund të ndikojë negativisht në përpjekjet e imunizimit. Komunikimi efikas i krizave do të kërkojë reagim të koordinuar për të menaxhuar situatat e krizave në rast të efekteve të lidhura me vaksinat dhe ngjarjeve negative pas imunizimit.

Do të zhvillohet plani i veprimit për komunikimin e krizave i cili do të përcaktojë hapat që do të ndërmerren në rastin e EPPV dhe specifikojë rolet dhe përgjegjësitë. Koordinimi i ngushtë midis zyrtarëve të komunikimit dhe grupit të ekspertëve përgjegjës për hetimin e rasteve të EPPV parashikohet për të siguruar komunikim proaktiv dhe në kohë me publikun për efektet e padëshirueshme pasvaksinale dhe për të adresuar thashethemet dhe dezinformatat përkatëse. Pasi të ketë përfunduar hetimi i rasteve të EPPV, do të përgatitet raporti i hollësishëm dhe do t'i dorëzohet MSH nga grupi i ekspertëve për të informuar komunikimin me publikun. Për më tepër, përgjigja e komunikimit të krizës do të informohet nga dëgjimi social dhe reagimet e komunitetit.

Objektivi: Të mbështetet besimi në programin e imunizimit përmes menaxhimit efikas të situatës së krizave në rast të ngjarjeve të lidhura me vaksinat dhe EPPV.

Intervenimi:

1. Komunikimi i krizës i realizuar

- a) *Të zhvillohet dhe zbatohet plani i veprimt të komunikimit të krizës që përcakton hapa të qartë për t'u ndjekur në reagim të ngjarjeve eventuale të lidhura me vaksinën dhe ngjarjeve negative pas imunizimit.*

Gjenerimi i të dhënave dhe shpërndarja e informacionit

Të përdoren kanale të ndryshme të komunikimit, përfshirë mediat dhe mediat sociale, për të ndarë në mënyrë proaktive informata në lidhje me vaksinimin në përgjithësi dhe komunikimin e rreziqeve, për të menaxhuar pritjet dhe për të rritur ndërgjegjësimin dhe besimin e publikut në procesin e shpërndarjes.

Fushatat e ndërgjegjësimit publik do të bazohen në dëshmi. Instituti i Shëndetësisë Publike me mbështetjen e OBSH-së, së fundmi, ka realizuar Anketën e Njohurive të Sjelljes me popullatën në Kosovë dhe është në proces të publikimit të të dhënave. Të dhënat nga anketa do të përdoren për njoftimin e fushatës së komunikimit për vaksinën kundër COVID-19.

Objektivi: Të sigurohet dhe ruhet besimi në programin e vaksinave përmes bashkëpunimit të ngushtë, transparencës me mediat dhe komunikimit të rregullt me publikun e gjerë.

1. Të sigurohet informacion i rregullt mbi programin e vaksinimit kundër COVID-19 përmes burimeve të besuara në gjuhët lokale
- a) *Të përditësohet rregullisht uebfaqja e IKSHPK-së për të siguruar informacion në kohë mbi programin e vaksinimit, shpërndarjen e vaksinave, numrat e imunizimit dhe komunikimin në situata rreziku.*
- b) *Të përcaktohen cilat kanale komunikimi (media dhe mediat sociale) do të përdoren për shpërndarjen e informacionit në lidhje me mesazhet e vaksinimit, duke marrë parasysh preferencat e audiencave të ndryshme për kanalet e komunikimit.*
- c) *Të përzgjidhen materialet më optimale të komunikimit*
- d) *Të zhvillohen materiale komunikimi për të informuar publikun mbi shpërndarjen e vaksinave, komunikimin në kohë rreziku, prioritizimin e grupeve etj.*

Grupet e synuara

1. Akterët kryesorë të përfshirë në futjen e vaksinës kundër COVID-19 në përdorim
- Komiteti për vaksinimin me vaksinat kundër COVID-19
 - Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike
 - Zyrat Rajonale të Institutit të Shëndetësisë Publike
 - Kujdesi Parësor Shëndetësor
 - Organizatat partnere lokale dhe ndërkombëtare: (OBSH, UNICEF, BB, OJQ-të lokale)

2. Personeli shëndetësor
3. Grupet me Rrezik të Lartë
 - Përfituesit dhe personeli i institucioneve të kujdesit afatgjatë (shtëpitë e të moshuarve)
 - Personat mbi moshën 65 vjeç
 - Personat me sëmundje kronike
 - Ofruesit e shërbimeve esenciale (policia, ushtria, mësimdhënësit dhe grupet e tjera relevante në Kosovë)
4. Një pjesë e popullsisë e cila nuk është përfshirë në grupet prioritare për imunizim (menaxhimi i pritjeve)
 - Akterët kryesorë
 - Shoqëria civile
 - Udhëheqësit e komunitetit (grupe fetare ose etnike)
 - Ekspertët dhe akademia
 - OJQ-të
5. Përfaqësuesit e mediave masive dhe sociale
 - Kanalet televizive qendrore dhe rajonale (përfshirë kanalet televizive etnike që transmetojnë në gjuhët e pakicave)
 - Radio
 - Grupet e mediave sociale dhe “ndikuesit”
 - Uebfaqja e MSH dhe IKSHPK
 - Facebook, Instagram, Twitter

Fazat e zbatimit dhe intervenimet prioritare

Përdorimi i njoftimeve në kohë për fazën aktuale të programit të vaksinimit kundër COVID-19.

- Para fillimit të vaksinimit
- Odat mjekësore (mjekëve dhe infermierëve) janë të angazhuar në komunikimin rreth vaksinimit kundër COVID-19 të punëtorëve shëndetësorë. Të dy odat do të mobilizohen më tej për të rritur kërkesën për vaksinim midis profesionistëve shëndetësorë.

Veprimet kryesore dhe prioritetet strategjike

Tabela Nr. 12 Afati kohor i ndërhyrjeve dhe veprimeve kryesore

Ndërhyrja	Veprimi/Ndryshimi	Përgjegjës	Afati kohor
Dëgjimi Social dhe Angazhimi Digjital	Themeloni ekipin kombëtar; Trajnim i kryer për dëgjimin social; Zhvillimi i fushatës së mediave sociale	IKSHPK, MSH në bashkëpunim me UNICEF	Shkurt 2021- Dhjetor 2021
Angazhoni ndikues të ndryshëm të komunitetit për të promovuar vaksinimin	Identifikoni ndikuesit kryesorë të komunitetit; Organizoni takim informues; Organizoni fushata për angazhimin e komunitetit	TBD	Qershor 2021- Dhjetor 2021
Promovoni vaksinimin midis popullatave të synuara përmes programit të vizitave në shtëpi (VSh)	Trajnioni infermierë vizitorë në shtëpi për aftësitë e komunikimit rreth vaksinës kundër COVID-19; Promovoni imunizimin përmes vizitave të rregullta në shtëpi	MSH, IKSHPK	Shtator 2021 Në vazhdim
Trajnimi i punëtorëve shëndetësor në aftësitë e komunikimit dhe angazhimit të komunitetit	Zhvillimi i moduleve të trajnimit; Trajnimi i HCW; Zhvilloni materiale komunikimi	OBSH, IKSHPK, MSH, UNICEF	Në vazhdim 2021 Mars 2021
Komunikimi i krizave (plani i veprimit)	Zhvilloni planin e veprimit për komunikimin e krizës; Zbatoni planin e veprimit të komunikimit të krizës	IKSHPK, MSH, OBSH	Mars 2021 Në vazhdim
Shpërndarja e informacionit dhe komunikimi i rrezikut	Azhurnoni rregullisht faqen e internetit të IKSHPK-së me informacion në kohë për programin e vaksinimit; Zhvilloni materiale komunikimi të krizës ;	IKSHPK, MSH	Mars 2021 Në vazhdim

1. Të menaxhohet dezinformimi përmes dëgjimit social dhe fushatave të synuara
2. Të mobilizohen dhe angazhohen partnerët kryesorë dhe komuniteti në avokim
3. Të sigurohet informim efektiv i mediave dhe avokim i mediave
4. Të hartohet dhe zbatohet një plan veprimi për komunikimin e krizës
5. Të realizohet trajnimi i ofruesve të shërbimeve shëndetësore për aftësitë e komunikimit
6. Të jepen rregullisht informata të përditësuara për publikun mbi futjen në përdorim, shpërndarjen dhe përdorimin e vaksinave kundër COVID-19
7. Të sigurohet besimi i publikut në sigurinë, efikasitetin dhe futjen në përdorim të vaksinës kundër COVID-19;
8. Të shpërndahen njoftime aktive, në kohë, të qasshme dhe efektive për konsolidimin e komunitetit, menaxhimin e pritjeve, shëndetin publik dhe sigurinë
9. Të monitorohen dhe rishikohen burimet dhe fushatat e komunikimit në nivel vendi për të përmirësuar arritjen e vetëdijes për imunizim dhe besimin për grupet kryesore të synuara

7. Monitorimi i sigurisë së vaksinave dhe menaxhimi i EPPV dhe sigurisë së injektimit

Megjithëse vaksinat janë të sigurta dhe testohen përmes provave strikte klinike, mund të ndodh që të paraqiten reaksione negative. Efektet e Padëshirueshme Pasvaksinale (Eng: Adverse Effects Following Immunization - EPPV) janë çdo dukuri mjekësore që pason imunizimin, dhe që mund të ketë ose jo një ndërlidhje shkakësore me përdorimin e vaksinës.

Për programin kombëtar të imunizimit, Kosova prokuron vaksinat e parakualifikuara të OBSH-së përmes UNICEF-it. Për dy dekadat e fundit nuk është raportuar asnjë EPPV.

Monitorimi dhe menaxhimi i EPPV në Kosovë bazohet dhe drejtohet nga "*Manuali Global i Mbikëqyrjes së EPPV*" i OBSH-së dhe nga "*Manuali i Mbikëqyrjes së EPPV*" i hartuar nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës. I njëjti sistem mbikëqyrjeje do të përdoret për të monitoruar dhe hetuar çdo EPPV të mundshëm nga vakcina COVID-19.

Siç përcaktohet nga manuali i *Mbikëqyrjes së EPPV-it në Kosovë*, rastet e mundshme të EPPV do të raportohen nga: (1) punëtorët shëndetësor të angazhuar në shërbimet e imunizimit; (2) punëtorët shëndetësor të specializuar në rastet EPPV; dhe (3) vetë marrësit e vaksinës. Të gjithë punëtorët shëndetësor të angazhuar në programin e imunizimit do të marrin trajnim shtesë për rastet EPPV, para vaksinimit me COVID-19 (për më shumë detaje mbi menaxhimin dhe trajnimin e burimeve njerëzore, shihni seksionin 5)

Raportet do t'i dorëzohen një grupi ekspertësh që do të themelohet, të cilët do të jenë përgjegjës për hetimin e mëtejshëm të rasteve EPPV. Ky grup i ekspertëve do të kryesohet nga një përfaqësues i njësisë farmakovigjilente të Agjencisë së Barnave të Kosovës dhe do të ketë anëtarë nga Ministria e Shëndetësisë, Programi Kombëtar i Imunizimit dhe Inspektorati Farmaceutik. OBSH dhe UNICEF do të ofrojnë ndihmë nëse kërkohet nga ekipi hetues. Ky ekip do të hetojë rastet e mundshme të EPPV të raportuara nga punëtorët shëndetësorë, por edhe rastet e mundshme të EPPV të ngritura nga komuniteti. Ky ekip do të jetë gjithashtu përgjegjës për vlerësimin e shkakësisë. Vendimi për krijimin e këtij grupi është planifikuar të merret nga Ministria e Shëndetësisë në Shkurt 2020, para vaksinimit kundër COVID-19.

Formulari i hetimit të rasteve EPPV i zhvilluar nga OBSH do të përkthehet dhe përdoret për qëllimin e hetimit të rasteve të EPPV gjatë vaksinimit kundër COVID-19²⁸. Para vaksinimit, do të sigurohet trajnim i veçantë për secilën ekip për menaxhimin e reaksionit anafilaktik, i cili do të integrohet në seancat e trajnimit të zhvilluara për ekipet e vaksinimit.

Për sa i përket sigurisë së injektimit, i njëjti sistem do të përdoret si për imunizimin rutinë: shiringa të autoshkatërruara, shiringa me një përdorim për hollues, kuti sigurie prej 5 litra dhe vend i sigurt kolektiv për kutitë e mbushura të sigurisë. Do të mbahet trajnim për ekipet e vaksinimit për të siguruar "ngjarje sigurie" gjatë vaksinimit kundër COVID-19.

Menaxhimi i rrezikut

²⁸Formulari i hetimit EPPV i zhvilluar nga OBSH: https://www.who.int/vaccine_safety/initiative/investigation/EPPV_Investigation_form_2Dec14.pdf

Siç u tha në seksionin e mëparshëm, një rëndësi e veçantë do t'i kushtohet komunikimit të rasteve të mundshme EPPV. Koordinimi i ngushtë midis zyrtarëve të komunikimit dhe grupit të ekspertëve përgjegjës për hetimin e rasteve të EPPV parashikohet për të siguruar komunikim proaktiv dhe në kohë me publikun për efektet e padëshirueshme pasvaksinale dhe për të adresuar thashethemet dhe dezinformatat përkatëse. Pasi të ketë përfunduar hetimi i çështjeve EPPV, raporti i hollësishëm do të përgatitet dhe do t'i dorëzohet MSH nga grupi i ekspertëve për të informuar komunikimin me publikun. Për më tepër, përgjigja e komunikimit në lidhje me krizat do të informohet nga dëgjimi social dhe informatat kthyesë nga komuniteti.

8. Sistemi i monitorimit të imunizimit

Për monitorimin e imunizimit, një modul i veçantë për vaksinimin kundër COVID-19 do të integrohet në Web aplikacionin e Sistemit të Informimit Shëndetësor (SISH). Në këtë modul, do të futen të dhënat personale të personave që marrin vaksinën. Web aplikacioni është i lidhur me regjistrin civil, i cili lejon nxjerrjen e të dhënave të sakta personale të secilit person (emri, mbiemri, data e lindjes, adresa, etj.) duke e shkruar vetëm numrin personal. Futja e të dhënave për vaksinimin kundër COVID-19 do të kryhet në kohë reale nga profesionistë shëndetësorë në kohën e marrjes së vaksinës.

Përveç regjistrimit dhe monitorimit të digjitalizuar të futjes së të dhënave, një kopje fizike e regjistrit të të dhënave dhe kartelave të vaksinimit do të sigurohet në çdo vend ku kryhet vaksinimi, duke përfshirë protokollat e rregullta që përdoren për Programin e Zgjeruar të Imunizimit (EPI).

Kategoritë e të dhënave që do të futen në sistem në kohën e vaksinimit përfshijnë:

- Të dhënat personale të qytetarit, siç janë numri personal, emri, mbiemri, data e lindjes, adresa, etj. Profesionisti shëndetësor duhet të shkruaj vetëm numrin personal të qytetarit, ndërsa të dhënat e tjera gjenerohen nga regjistri civil.
- Numri unik i identifikimit, siç është numri serik. Kjo gjenerohet automatikisht nga sistemi dhe do të printohet në secilën kartelë.
- Profesionin bazuar në një kategorizim të siguar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.
- Lloji i vaksinës dhe numri i serisë.
- Doza(t) e vaksinës, nëse është doza e parë, e dyta ose tjetër e vaksinës që merret.
- Detaje të mjekut të ekipit të vaksinimit. Ky informacion gjenerohet automatikisht bazuar në emrin e përdoruesit me të cilin është kyçur mjeku.
- Detajet e infermierit/infermieres që ka administruar vaksinën
- Data e vaksinimit, e cila gjenerohet automatikisht nga sistemi në datën e regjistrimit të të dhënave në sistem.

Në varësi të llojit të vaksinës së zgjedhur, sistemi do të rekomandojë datën e vaksinimit për dozën tjetër. Rekomandimi do të bëhet automatikisht bazuar në intervalin e rekomanduar midis dy dozave për secilën vaksinë.

Secili person i vaksinuar do të pajset në kohë reale me kartelën e imunizimit për vaksinën kundër COVID-19 të gjeneruar nga sistemi. Kartela e gjeneruar duhet të vuloset dhe të nënshkruhet nga profesionistët shëndetësorë (mjeku ose infermierja që kanë marrë pjesë në administrimin e vaksinës).

Lidhur me sigurinë dhe gjurmueshmërinë e saktësisë së të dhënave, kjo do të sigurohet përmes numrit personal të qytetarit dhe numrit unik të identifikimit i cili gjenerohet automatikisht nga sistemi.

Treguesit për analizimin dhe raportimin e të dhënave të vaksinimit

Raportet në kohë reale mund të gjenerohen nga sistemi. Të dhënat e ndara do të sigurohen për:

1. Numrin e njerëzve të vaksinuar sipas secilit lloj të produktit të vaksinës
2. Numrin e njerëzve të vaksinuar sipas secilës komunë

3. Numrin e njerëzve të vaksinuar sipas secilës komunë dhe grupmoshës
4. Numrin e njerëzve të vaksinuar sipas gjinisë
5. Numrin e njerëzve të vaksinuar sipas grupmoshës
6. Numrin e njerëzve të vaksinuar sipas profesionit
7. Numrin e njerëzve të vaksinuar me secilën dozë të vaksinës (Kjo mund të përfshijë numrin e njerëzve që e kanë marrë dozën e parë, numrin e njerëzve që kanë marrë dy doza ose ata që nuk kanë arritur ta marrin dozën e dytë në kohën e rekomanduar).

Platforma është e qasshme për popullatën e gjerë, dhe informacioni në lidhje me procesin e vaksinimit mund të nxirret në çdo kohë nga kushdo që mund të ketë interes.

Së fundmi, sistemi i menaxhimit të termineve do të përfshihet gjithashtu në modulën e vaksinimit kundër COVID-19 në Sistemin e Informimit Shëndetësor, i cili do të mundësojë terminet online për çdo person që do ta marrë vaksinën.

9. Mbikëqyrja e sëmundjes

Qëllimet dhe objektivat

Qëllimi i mbikëqyrjes kombëtare për COVID-19 është të lejojë autoritetet e shëndetësisë publike të ulin transmetimin e COVID-19, duke kufizuar kështu sëmundshmërinë dhe vdekshmërinë.

Objektivat e mbikëqyrjes së COVID-19 janë:

- Të mundësojë zbulimin, izolimin, testimin dhe menaxhimin e shpejtë të rasteve
- Të monitorojë trendet e rasteve me COVID-19 dhe të vdekjeve
- Të identifikojë, përcjellë dhe karantinojë kontaktet
- Të zbulojë dhe mos lejojë grupimet, veçanërisht midis grupeve të cënueshme
- Të udhëzojë zbatimin dhe rregullimin e masave të synuara të kontrollit, duke mundësuar rifillimin e sigurt të aktiviteteve ekonomike dhe sociale
- Të vlerësojë ndikimin e pandemisë në sistemet e kujdesit shëndetësor dhe shoqëri
- Të kontribuojë në të kuptuarit e bashkëqarkullimit të virusit SARS-CoV-2, gripit dhe viruseve të tjerë të frymëmarrjes dhe patogjenëve të tjerë.

Monitorimi i situatës mundësohet me mbikëqyrje të përhershme përmes raportimit të sëmundjeve infektive, që është e detyrueshme dhe e rregulluar nga Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse (Ligji Nr. 02/L-109) dhe Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 në Territorin e Republikës së Kosovës (Nr. 07/L-006).

Monitorimi i situatës bëhet përmes një sistemi të rregullt, rutinor, të mbikëqyrjes së sëmundjes infektive dhe mbikëqyrjes së bazuar në ngjarje. Mbikëqyrja duhet të sigurojë të dhëna themelore përmes

raportimit të cilat duhet të bazohen në përkufizime standarde (përcaktimi i rastit). Gjithashtu, duhet të raportohen edhe rastet e importuara nga vendet e tjera.

Për një monitorim dhe vlerësim më efikas, në mënyrë që të sigurojë zbulimin e hershëm të rasteve në nivel kombëtar, sistemi do të sigurojë:

- Mbikëqyrje të përhershme: aktive, pasive dhe të kombinuar;
- Raportim të detyrueshëm edhe në rast dyshimi (vetëm me shenja klinike);
- Mbikëqyrje të bazuar në të dhënat laboratorike (publike dhe private);
- Hulumtime specifike të popullsisë (faktorët e rrezikut);
- Mbikëqyrje të kontrollit në rast të indikacionit se masat ekzistuese duhet të përmirësohen;
- Sistem të informimit (listat e lindjeve, vdekjeve, fletë-lëshimet nga spitali, etj.);
- Lidhje të të dhënave nga burime të ndryshme (Go.Data).

Sistemi i mbikëqyrjes së sëmundjes COVID-19 në Kosovë bazohet në platformën elektronike Go.Data. Platforma Go.Data është zhvilluar dhe dizajnuar nga OBSH-ja dhe shërben për të menaxhuar epideminë dhe ofron mundësinë e gjurmimit të kontakteve dhe identifikimin e zinxhirit të transmetimit. Produkti përfundimtar është paneli i jashtëm që ofron informacionin bazë të nevojshëm.

Me forcimin e sistemit rutinor të mbikëqyrjes (pasiv dhe aktiv) para dhe gjatë epidemisë mundësohet:

- Raportimi i rasteve brenda 24 orëve (menjëherë pas dyshimit)
- Mbledhja dhe përpunimi i informacionit ditor, javor dhe mujor
- Përpilimi i raporteve ditore, javore, adhoc dhe vjetore
- Zero-raportimi: javor dhe mujor
- Përfshirja e të gjitha niveleve të sistemit shëndetësor
- Konfirmimi laboratorik i rasteve: rrjeti i laboratorëve, laboratorë të akredituar nga OBSH, forcimi i kapaciteteve laboratorike
- Zhvillimi i burimeve njerëzore me shumë qëllime (kërkime, analiza, planifikime)
- Mbulimi i sistemit është gjithëpërfshirës (niveli parësor, dytësor dhe tretësor)
- Informatat kthyesë (feedback) duhet të dërgohen rregullisht në nivelet rajonale dhe komunale

Të gjitha burimet e të dhënave aktivizohen në sistemin e mbikëqyrjes. Kjo në të njëjtën kohë paraqet pjesën kryesore pa të cilën nuk mund të funksionojë asnjë sistem i mbikëqyrjes.

Sistemi i raportimit të sëmundjes infektive: Raportimi i detyrueshëm i sëmundjes infektive (qendrat e mjekësisë familjare, spitalet, laboratorët, klinikat) janë burimet bazë të të dhënave të këtij sistemi;

Anketa epidemiologjike: është një pjesë ndihmëse por e rëndësishme e sistemit të mbikëqyrjes. Anketa epidemiologjike heton rastin dhe merr të dhëna shumë të rëndësishme që plotësojnë këtë sistem;

Laboratori: konfirmimi laboratorik i rasteve dhe raportimi i tyre është i detyrueshëm;

Statistikat vitale: janë një pjesë ndihmëse e sistemit të mbikëqyrjes. Statistikat vitale mundësojnë analizën e të dhënave të raportuara në këtë sistem dhe llogaritjen e parametrave të ndryshëm statistikorë dhe treguesve shëndetësorë;

Rrjeti i qendrave/programeve për mbikëqyrje specifike (roje).

10. Vlerësimi i futjes në përdorim të vaksinave kundër COVID-19

Në mënyrë që të vlerësohet ndikimi i futjes në përdorim të vaksinës kundër COVID-19, Kosova do të kryejë një vlerësim pas futjes së saj në përdorim. Kjo do të bazohet në metodat e përshkruara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë për vlerësimin e vaksinës së re pas futjes në përdorim (PIE). Objektivi është identifikimi i problemeve të mundshme në aspekte të ndryshme të procesit të vaksinimit. Siç përcaktohet nga mjeti i OBSH-së për PIE, të dhënat do të grumbullohen në 10 fusha të vlerësimit:

1. Planifikimi dhe futja në përdorim.
2. Mbulimi, mos marrja (braktisja), regjistrimi dhe raportimi.
3. Menaxhimi i zinxhirit të ftohtë.
4. Menaxhimi i vaksinave, transporti dhe logjistika.
5. Monitorimi dhe mbikëqyrja.
6. Trajnimi dhe njohuritë e punonjësve shëndetësorë.
7. Siguria e injeksionit dhe menaxhimi i mbetjeve.
8. Hedhurinat e vaksinave.
9. Efektet anësore pas imunizimit.
10. Avokimi, komunikimi dhe pranimi.

OBSH rekomandon që PIE të kryhet të paktën gjashtë muaj pas futjes së vaksinës në përdorim. Për vaksinat kundër COVID-19 në Kosovë, PIE do të kryhet gjatë implementimit të fazës së tretë të vaksinimit, e cila përfshin gjashtë muaj të futjes së vaksinës. Kryerja e një vlerësimi pas futjes në përdorim do t'i lejojë institucionet të bëjnë ndryshime në sistem, në mënyrë që të përmirësojnë procesin e vaksinimit në fazat vijuese të vaksinimit.

Agjenda e vlerësimit

Agjenda e vlerësimit do të përfshijë aktivitetet e mëposhtme:

Aktiviteti

Afati kohor

1. Trajnimi i vlerësuesve, testimi dhe finalizimi i pyetësorëve	1 ditë
2. Puna në terren	2 ditë
3. Futja e të dhënave, takimet me ekipet vlerësuese, diskutimi i gjetjeve kryesore dhe përpunimi i rekomandimeve	6 ditë
4. Analiza e të dhënave dhe hartimi i raportit	14 ditë
5. Prezantimi i rezultateve të vlerësimit tek palët kryesore të interesit (MSH, ICC, GPT-të)	0,5 ditë
6. Diskutimi i gjetjeve kryesore të PIE dhe finalizimi i rekomandimeve	0,5 ditë

Vlerësimi do të kryhet nga një ekip profesionistësh nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike, Ministria e Shëndetësisë, Autoriteti Rregullator Kombëtar, UNICEF dhe OBSH. Siç përcaktohet në agjendën e vlerësimit, i gjithë vlerësimi do të kryhet brenda 24 ditësh. Vlerësimi do të bëhet duke përdorur pyetësorë të siguruar nga OBSH, të modifikuar për kontekstin e Kosovës. Puna në terren do të përbëhet nga vizita në nivelet qendrore dhe rajonale, ku do të bëhet vaksinimi. Në total do të ketë vizita në 8 institucione shëndetësore: në deponinë qendrore të vaksinave në kryeqytet, pra në Prishtinë, dhe në institucionet shëndetësore në 7 rajone.

Shtojca 1: Formulari i Hetimit të EPPV-ve

Seksioni A		Detajet themelore			
Provincia/Shteti	Qarku	ID e rastit			
Vendi i vaksinimit(✓): Inst. shënd. qeveritar	Insti. shënd. privat	Tjetër(specifiko) _____			
Vaksinimi në(✓): Kampanjë	Rutinë	Tjetër(specifiko) _____			
Adresa e vendit të vaksinimit:					
Emri i Zyrtarit Raportues:		Data e hetimit: ____/____/____			
Titulli / Pozita:		Data e plotësimit të formularit: ____/____/____			
Telefoni # fiks (me kod):		Ky raport është: <input type="checkbox"/> I paril përkohshëm <input type="checkbox"/> Përfundimtar			
		Mobil: _____ e-mail: _____			
Emri i pacientit			Gjinia: M F		
(përdorni një formë të veçantë për secilin rast në një grupim)					
Data e lindjes (DD/MM/VVVV): ____/____/____					
OSE Mosha në fillim: ____ vjeç ____ muaj ____ ditë OSE Grupmosha: <1vjeç 1-5vjeç > 5vjeç					
Adresa e plotë e pacientit me pikë referimi (Emri i rrugës, numri i shtëpisë, lokaliteti, numri i telefonit etj.):					
Emri i vaksinave/holluesit të marrë nga pacienti	Data e vaksinimit	Koha e vaksinimit	Doza (p.sh. e 1-rë, e 2-të, etj.)	Numri i Serisë/i Llotit	Data e skadimit
				Vaksina	Vaksina
				Hollues	Hollues
				Vaksina	Vaksina
				Hollues	Hollues
				Vaksina	Vaksina
				Hollues	Hollues
				Vaksina	Vaksina
				Hollues	Hollues
				Vaksina	Vaksina
				Hollues	Hollues
Lloji i vendit të vaksinimit(✓) <input type="checkbox"/> I fiksuar <input type="checkbox"/> Mobil <input type="checkbox"/> Në terren Tjetër __					
Data e simpt. së parë/kryesore(DD/MM/VVVV): ____/____/____ Koha e simpt. së parë(ora/min): ____/____					
Data e shtrimit në spital(DD/MM/VVVV): ____/____/____					
Data e raportimit të parë tek autoriteti shëndetësor(DD/MM/VVVV): ____/____/____					
Statusi në datën e hetimit(✓): <input type="checkbox"/> I vdekur <input type="checkbox"/> I paaftë <input type="checkbox"/> I shëruar <input type="checkbox"/> I shëruar plotësisht <input type="checkbox"/> I panjohur Nëse ka					
vdekur, data dhe koha e vdekjes(DD/MM/VVVV): ____/____/____ (ora/min): ____/____					
Është kryer autopsia?(✓) Po (data) ____ <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/> Planifikuar më (datë) ____ Koha					
Bashkëngjitni raportin (nëse është në dispozicion)					

Seksioni B	Informacion përkatës i pacientit para imunizimit	
K riteret	Gjetja	Vërejtje (Nëse po jepni detaje)
Historia e kaluar e një efekti të ngjashëm	Po/Jo/Nuk dihet	
Efektet anësore pas vaksinimit/-eve të mëparshme	Po/Jo/Nuk dihet	
Historia e alergjisë ndaj vaksinës, ilaçeve ose ushqimit	Po/Jo/Nuk dihet	
Sëmundje paraekzistuese (30 ditë) / çrregullim i lindur	Po/Jo/Nuk dihet	

shkakun	uk dihet
Pacienti aktualisht me ilaçe shoqëruese? (Nëse po, emëroni ilaçin, indikacionin, dozat dhe datat e trajtimit)	Po/Jo/N uk dihet
Histori familjare e ndonjë sëmundjeje (e rëndësishme për EPPV) ose alergji	Po/Jo/N uk dihet
Për gratë e rritura	
<ul style="list-style-type: none"> • Aktualisht shtatzënë? Po(javët) _____ / Jo /Nuk dihet • Aktualisht gjdhënëse? Po /Jo 	
Për foshnjat	
<input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> Lindja ishte afat te plotëparaafatitpas afatit.	Pesha në lindje:
<input type="checkbox"/> Procedura e lindjes ishte <input type="checkbox"/> Normale <input type="checkbox"/> Cezariane me komplikim (specifiko)	<input type="checkbox"/> E asistuar (pincë, vakum etj.)

a) Kur u imunizua pacienti?(<input checked="" type="checkbox"/> kutinë më poshtë dhe përgjigjuni të GJITHA pyetjeve)	
Brenda vaksinimeve të para të seancës fundit të seancës	<input type="checkbox"/> Brenda vaksinimeve të Nuk dihet
Në rast të flakoneve shumë doza, a është dhënë vakuina disa dozave të para të flakonit të administruar? brenda dozave të fundit të flakonit të administruar?	<input type="checkbox"/> brenda nuk dihet?
b) A ka pasur ndonjë gabim në përshkrimin ose mosrespektimin e rekomandimeve për përdorimin e kësaj vaksine?	Po*/ Jo
c) Bazuar në hetimin tuaj, a mendoni se vakcina (përbërësit) e administruar mund të ketë qenë josterile?	Po*/ Jo / E pamundur të vlerësohet
d) Bazuar në hetimin tuaj, a mendoni se gjendja fizike e vaksinës (p.sh. ngjyra, turbullira, substanca të huaja etj.) ishte anormale në kohën e administrimit?	Po*/ Jo / E pamundur të vlerësohet
e) Bazuar në hetimin tuaj, a mendoni se ka pasur një gabim në rikonstruktimin/përgatitjen e vaksinës nga vaksinuesi (p.sh. produkt i gabuar, hollues i gabuar, përzierje e pasaktë, mbushje e papërshtatshme e shiringës etj.)?	Po*/ Jo / E pamundur të vlerësohet
f) Bazuar në hetimin tuaj, a mendoni se ka pasur ndonjë gabim në trajtimin e vaksinës (p.sh. ndërprerja e zinxhirit të ftohtë gjatë transportit, ruajtjes dhe/ose seancës së imunizimit etj.)?	Po*/ Jo / E pamundur të vlerësohet
g) Bazuar në hetimin tuaj, a mendoni se vakcina është administruar gabimisht (p.sh. doza e gabuar, vendi ose rruga e administrimit, madhësia e gabuar e gjilpërës, mos-ndjekja e një praktike të mirë injeksioni etj.)?	Po*/ Jo / E pamundur të vlerësohet
h) Numri i personave të imunizuar nga flakoni/ampula e vaksinës përkatëse	
i) Numri i personave të imunizuar me vaksinën përkatëse në të njëjtën seancë	
j) Numri i personave të imunizuar me vaksinën përkatëse që ka të njëjtin numër serie(ang. "batchnumber") në lokacionet e tjera. Specifikoni lokacionet:	
k) A mundet vakcina e dhënë këtij pacienti të ketë një defekt cilësor apo është nën standard apo e falsifikuar?	Po*/ Jo / E pamundur të vlerësohet
l) A mund të jetë ky efekt një reagim stresi në lidhje me imunizimin (p.sh. reagimi akut i stresit, reagimi vazovagal, hiperventilimi, reagimi i simptomës neurologjike disociuese etj.)?	Po*/ Jo / E pamundur të vlerësohet
m) A është kjo çështje pjesë e një grupimi (ang. "cluster")?	Po*/ Jo / Nuk dihet
i. Nëse po, sa raste të tjera janë zbuluar në këtë grupim?	
a. A e morën vaksinën nga i njëjtiflakontë gjitha rastet në grupim?	Po*/ Jo / Nuk dihet
b. Nëse jo, numri i flakoneve të përdorura në grupim (shënoni detajet veç e veç)	

*Është e detyrueshme që të jepni shpjegime për këto përgjigje veç e veç

Seksioni E Praktikrat e imunizimit në vendin/-et ku është përdorur vakcina përkatëse (Plotësoni këtë seksion duke pyetur dhe/ose duke vëzhguar praktikën)							
<input type="checkbox"/> Shiringat dhe gjilpërat e përdorura: <input type="checkbox"/>							
• A përdoren shiringat AD për imunizim?	Po / Jo / panjohur						
Nëse jo, specifikoni llojin e shiringave të përdorura: <input type="checkbox"/> Qelqi Njëpërdorimëshe <input type="checkbox"/> E riciklueshmenjëpërdorimëshe Tjetër _____							
Gjetjet kryesore specifike/vëzhgimet dhe komentet shtesë:							
Rikonstruktimi: (plotësoni vetëm nëse është e aplikueshme), ✓ NA nëse nuk aplikohet)							
• Procedura e rikonstruktimit(✓) Shiringë e rikonstruktimit të njëjtë përdoret për flakonetë shumta të së njëjtës vaksinë?	<table border="1"> <tr> <th colspan="3">Statusi</th> </tr> <tr> <td>o</td> <td>o</td> <td>A</td> </tr> </table>	Statusi			o	o	A
Statusi							
o	o	A					

Shiringë e rikonstruktimit të njëjtë përdoret për rikonstruktimin e vaksinave të ndryshme?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	A
Shiringë e rikonstruktimit të veçantë për secilin flakontë vaksinës?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	A
Shiringë e rikonstruktimit të veçantë për çdo vaksinë?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	A
• A përdoren vaksinat dhe holluesit e njëjtë si ata të rekomanduar nga prodhuesi?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	A

Gjetjet kryesore specifike/vëzhgimet dhe komentet shtesë:

Teknika e injektimit nga vaksinuesi/-t: (Vëzhgoni një seancë tjetër në të njëjtin lokalitet –vendi i njëjtë ose tjetër)	
• Doza dhe rruga e saktë?	Po / Jo
• Koha e rikonstruktimit e përmendur në flakon? (në rast të ngrirjes së vaksinave të thara)	Po / Jo
• Ndiqet teknika pa prekje?	Po / Jo
• Kundërlindikacionetshqyrtohen para vaksinimit?	Po / Jo
• Sa EPPV u raportuan nga qendra që shpërndau vaksinën në 30 ditët e fundit?	Po / Jo
• Trajnimi i marrë nga vaksinuesi? (Nëse Po, specifikoni datën e trajnimit të fundit _____)	Po / Jo
<i>Gjetjet specifike kryesore/vëzhgimet dhe komentet shtesë:</i>	

Seksioni F Zinxhiri i ftohjes dhe transporti	
<i>(Plotësoni këtë seksion duke pyetur dhe/ose vëzhguar praktikën)</i>	
Pika e fundit e ruajtjes së vaksinës:	
• A monitorohet temperatura e frigoriferit për ruajtjen e vaksinave?	Po / Jo
○ Nëse "po", a kishte ndonjë devijim jashtë 2-8 °C pasi u vendos vakcina brenda?	Po / Jo
○ Nëse "po", jepni detajet e monitorimit veç e veç.	
• A u ndoq procedura e saktë për ruajtjen e vaksinave, holluesve dhe shiringave?	Po / Jo / Nuk dihet
• A ka qenë ndonjë send tjetër (përveç vaksinave dhe holluesve EPI) në frigorifer apo ngrirës?	Po / Jo / Nuk dihet
• A kishte në frigorifer ndonjë vaksinë të rikonstruktuar e të përdorur pjesërisht?	Po / Jo / Nuk dihet
• A kishte në frigorifer ndonjë vaksinë të papërdorshme (të skaduar, pa etiketë, VVM në fazat 3 ose 4, e ngrirë)?	Po / Jo / Nuk dihet
• A kishte në depo ndonjë hollues të papërdorshëm (të skaduar, prodhuesi nuk përputhej, të plasaritur, ampulë e ndyrë)?	Po / Jo / Nuk dihet
<i>Gjetjet specifike kryesore/vëzhgimet dhe komentet shtesë:</i>	
Transporti i vaksinave:	
• Lloji i përdorur i transportuesit të vaksinës	
• A u dërgua transportuesi i vaksinës në vendin e vaksinimit në të njëjtën ditë me vaksinimin?	Po / Jo / Nuk dihet
• A u kthye transportuesi i vaksinës nga vendi i vaksinimit në të njëjtën ditë me vaksinimin?	Po / Jo / Nuk dihet
• A është përdorur një pako akulli e kondicionuar?	Po / Jo / Nuk dihet
<i>Gjetjet specifike kryesore/vëzhgimet dhe komentet shtesë:</i>	

Seksioni G Hetimi i komunitetit (Ju lutemi vizitoni lokalitetin dhe intervistoni prindërit/të tjerët)

A është raportuar ndonjë efekt i ngjashëm brenda një periudhe kohore të ngjashme me atë kur ka ndodhur efekti anësor dhe në të njëjtin lokalitet? Po / Jo / Nuk dihet Nëse po, përshkruani:

Nëse po, sa efekte/episode?

Nga ata që janë prekur, sa

- Janë vaksinuar: _____
- Nuk janë vaksinuar: _____
- Nuk dihet: _____

Komente të tjera: